



shqipëria Etnike



Fati ynë nuk është shkruar për ne, por është shkruar prej nesh!

OBAMA

E hënë
3 mars 2014

Viti XIV
nr 154

Cmimi
30 L / 1 euro

E pavarur,
periodike

www.shqiperia-etnike.com
shqiperia_etnike@yahoo.com

English, page 14

Drejtore
Sokol Pepushaj



PËRSE DEPUTETËT KËMB-ËNGULIN TË SHKELIN LIGJIN?!
nga Andre Stefani



KATËR TË FORTËT T TIRANËS...
nga L. Vangjeli
faqe 5




KE FOLI SHQIP...

Sokol Pepushaj
faqe 3


Na mbyti varfëria në kulturë

nga Artan Fuga
faqe 7



Të majtët, të djathtët dhe fundamentalistët

nga Fatos Lubonja
faqe 6



Një libër shqip më i vjetër se "Meshari"

nga Behar Gjoka
faqe 10

Kthetrat e mazokizmit si idhujtari partitokratike ndryshe. Njëra nga sfidat më serioze të një Rilindjeje të vërtetë.



KABINETI QEVERITAR I Kryeministrit EDI RAMA



NIKO PELESHI



SAIMIR TAHIRI



MIRELA KUMBARO



NASIP NACO



MIMI KODHELI



BLEDI ÇUÇI



ARBEN AHMETAJ



ILIRJAN CELIBASHI



DAMIAN GJIKNURI



DITMIR BUSHATI



EDMOND HAXHINASTO



EGLANTINA GJERMEI



ERION VELIAJ



ILIR BEQAJ



KLAJDA GJOSHA



LEFTER KOKA



LINDITA NIKOLLA



MILENA HARITO



EDMOND PANARITI



SHKELQIM CANI

Reagimi sistematik grek, në dogana, në dëm të një komunikimi normal për mijëra e mijëra qytetarë shqiptarë: Fëmijë, gra, të moshuar, emigrantë me probleme dhe halle nga më alarmantet ka qenë gjithnjë një reagim aspak burokratik, teknik apo defektsh nga më të ndryshme, por ka qenë dhe do të jetë një strategji e vet shtetit grek për të qenë kurdoherë në raporte superioriteti me shtetin shqiptar, në kuptimin e asaj filozofie skllavëruese, që mjerisht prej kaq vitesh ushqehet nga sjellja mazokiste e vet klasës sonë politike. E theksoj këtë fakt, aspak për herë të parë, sepse cilado forcë politike, që ka ardhur në pushtet, mjerisht, ka heshtur apo thjesht është shtirur sikur po reagon ndaj akteve antishqiptare të grekëve, lexo të qeverisë së tyre, në kurriz të dinjitetit të shqiptarëve... / Kadri Ujka , faqe 8

TRITOLI SHQETESON KRYEMINISTRIN

Nga Artan Hoxha

Në takimin me mësuesit Kryeministri shprehu shqetësimin se tritoli pengonte vlerësimin e arritjeve Rilindëse në rendin dhe sigurinë publike.

Ai ia gjeti shpjegimin edhe rritjes së përdorimit të tritolit të dy shkaqe: i) meqë ai, bashkë me ministrin, Policinë e shpartalluar të Saliut po e rilindin si një Polici të supermobilizuar, atentatorët, të cilët kanë marrë paradhëniet nga porositësit përmes ndërmetësve, po nxitojnë të qërojnë hesapet sa kohë që kjo mrekulli Rilindëse nuk ka ndodhur plotësisht, përndryshe jo vetëm humbasin pjesën tjetër të pagesës, por duhet të kthejnë edhe paradhënien; ii) propaganda e shfrenuar – kryesisht opozitare – paska qenë për tritolin më efikase se reklama me shokun e Çimit. Me shifrat dhe argumentet Rilindëse ai shkoi “serbes” në interpelancën me Jozefina Topallin.

SUKSESI RILINDESE SIPAS STATISTIKAVE RILINDESE

Ministri i Brendshëm, në raportin vjetor të Policisë, në janar 2014, kritikoi mënyrën e mbajtjes së statistikave nga Policia si stil i vjetruar. Ai e mori në kujdesin e vet statistikën e kriminalitetit dhe po i përtyp shifrat si çamçakëzin – sa për të zbardhur dhëmbët e për të bërë poçe.

Edhe Kryeministri, edhe ministri, edhe raportet Rilindëse i kanë shumë për zemër krahasimet me të njëjtën periudhë të një viti më parë – me epokën e Saliut – si rregull, kur shifrat mbështesin sukseset Rilindëse, përndryshe shifrat e epokës së Saliut nuk përfshihen në raport.

Më poshtë jepen sukseset e Rilindësve sipas shifrave të tyre.

KRIMET KUNDËR PERSONIT

Në raportet tetor-shkurt jepet numri i vrasjeve edhe për të njëjtën periudhë të një viti më parë, e nga ku del se në epokën e Saliut vrasjet ishin më të shumta se në kohën e Rilindësve, por mungojnë shifrat e epokës së Saliut për vrasjet në tentativë, plagosjet e rënda dhe krimet gjithsej kundër personit. Pse kjo mungesë? Se, mos o zot, situata e sotme Rilindëse është më keq se ajo e Saliut një vit më parë?!

Edhe lidhur vetëm me vrasjet, shifrat për të cilat Rilindësit i kanë kaq për zemër, situata është në përkeqësim. Rilindësit e nisën mirë. Në nëntor deklaruan me forcë se vrasjet in afro 62.5% më pak se në nëntorin e Saliut.

Mrekullia e frymës se s’kishte ndonjë faktor real në veprim në ato fillime.

Por, situata nisi të japë shenja përkeqësimi nga fundi i dhjetorit, derisa në janar 2014 vrasjet ishin vetëm 15% më pak se në janarin e Saliut, ndërsa të vranët 15 me 14 për Rilindësit. Në shkurt 2014, fatmirësisht bomba me tritol në Tiranë nuk i vrau tri shënjestrat, por vetëm ua copëtoi gjymtyrët, përndryshe të vranët e shkurtit Rilindës do të ishin sa ato të shkurtit të Saliut dhe numri i vrasjeve vetëm 10% më pak.



E çuditshme! Sa më shumë Rilindësit merrnin komandën në dorë, aq më keq treguesit. Ishte shumë më mirë kur ishin vetëm frymë. Keq e mos më keq me kalimin e kohës.

KRIMET KUNDËR PRONËS

Për periudhën tetor-janar mungojnë shifrat e epokës së Saliut, ndërsa për epokën Rilindëse, në tetor 2013 rezultojnë vetëm 531 raste krimesh kundër pronës, në nëntor 566, në dhjetor 701 raste e në janar 2014 arrijnë në 733 raste. Rritje me afro 40% në pak muaj Rilindje.

Muaji shkurt Rilindësve iu duk ngushëllyes, pasi kishte vetëm 708 raste të krimeve kundër pronës. Harruan se shkurti ka 28 ditë dhe jo 31, sa janari, dhe për shkurtin rezultojnë mesatarisht 25 vjedhje çdo ditë, nga 23 të këtitilla në janar.

Në raportin e shkurtit jepen, për herë të parë, krahasimet e krimit kundër pronës me epokën e Saliut. Në shkurt 2014, krahasuar me shkurt 2013, ndodhën 22 vjedhje banesash më shumë; 15 vjedhje biznesesh më pak; 17 vjedhje makinash më pak; 4 vjedhje me dhunë më shumë; 2 shkatërrime prone me eksploziv më pak. Pra, pak a shumë si në kohën e Saliut. Kështu do kenë qenë edhe muajt pararendës.

U çudita kur pashë vullnetin për transparencë të Rilindësve në shkurt, edhe pse shifrat

i nxirrin njësoj me Saliun në krimin kundër pronës. Por kur pashë të nesërmen në mediat mbështetëse së në shkurt 2014 eksplozivi ishte përdorur më pak se në shkurt 2013, e kuptova arsyen pse Rilindësit u kandisën të krahasoheshin me Saliun në ca tregues. Ec e u thuaj pastaj se po përjetojmë kohën e tritolit. Mirë ne ia fusim kot, por edhe Arvizu kot ia futka!

SIGURIA RRUGORE

Për periudhën tetor-dhjetor mungojnë të dhënat për epokën e Saliut, por krahasimi shfaqet triumfues në raportin e janarit 2014. Ndonëse aksidentet në total në janar 2014 ishin më shumë se në janar 2013, vdekjet dhe plagosjet e rënda nga aksidentet ishin më pak. Rilindësit u rropatën tre muaj me radhë me gjopa parkingu dhe arrestime shoferësh të pirë e thuajse asgjë s’po ndryshonte. Por, më në fund, në janar 2014 sukcesi u arrit. Siguria rrugore më mirë se në kohën e Saliut.

Triumfi i janarit iu doli për hundësh në raportin e shkurtit, pasi u detyruan të pohojnë se aksidentet me vdekje ishin më të shumta se në shkurtin e Saliut, ndërsa plagosjet e rënda po aq sa në kohën e Saliut. Iu shkuan huq të gjitha përpjekjet me gjopa dhe arrestime. Nuk iu dha rezultat as edhe rritja e çmimit të naftës nga rritja e taksës. Të alarmuar vendosën të ndalojnë pjesë-pjesë qarkullimin e mjeteve. E nisën me furgonët, por po humbasin shpresat edhe te kjo masë.

Tashmë shpresën më të madhe e kanë te moti. E kuptuan se rekordi i ditëve pa shi në dhjetor e janar ishte ndihma më e madhe për sigurinë rrugore krahasuar me Saliun. Në shkurt, sapo u barazuan reshjet me epokën e Saliut, u rritën vdekjet dhe plagosjet në aksidentet rrugore. Po mbajti kohë e mirë, sukcesi është i tyre; nëse bie shi, ata s’kanë faj se motit s’kanë ç’t’i bëjnë.

TRAFIKU I DROGËS

Për sasi të barërave çudibërëse që janë kapur këndej kufirit, raportet Rilindëse janë plot me sukseste në rritje muaj pas muaji, e po kështu krahasuar edhe me epokën e Saliut, por asgjë nuk thuhet për sasi të kapura andej kufirit.

Siç tha ministri te Fevziu, bilanci i eksportit do të saktësohet pas një viti! Atij aq i bën se grekët po vigjilojnë maleve, ndërsa italianet po shohin se si Otranto është shndërruar në autostradë!

STRATEGJIA RILINDESE QE SOLLI SUKSESIN

A e dini se si i kanë arritur sukseset Rilindësit në luftën kundër vrasjeve, plagosjeve, vjedhjeve, bandave të organizuara, drogës, trafiqeve, tritolit?

Fare thjesht, duke përqendruar aksionin e policisë drejt pak prioriteteve. Këto prioritete – tri gjithsej – janë shpallur në raportet mujore që nga tetori 2013 deri në shkurtin 2014. Tri prioritete të pandryshuara të këtyre pesë muajve janë: i) ndërtimet abuzive; ii) prerja e pyjeve; iii) dhuna në familje.

A nuk është kjo një mrekulli?! Duke luftuar informalitetin arrin rezultate me kriminalitetin. Metodë me vlerë planetare. Thonë se OKB ka kërkuar ta përhapë në botë.

MINISTRIN E HEQIN NGA QARKULLIMI

Ministri i Brendshëm, njëherazi kryepolic, kryeinspektor tatimor, kryeinspektor ndërtimor, kryeinspektor kazinosh, kryeinspektor pyjesh e gjithfarë tjetër, prej një muaji e hoqën nga qarkullimi mediatic.

Publikut po i mungon ministri me celular në dorë duke dhënë urdhra gjithfarësoj. Ekranet televizive po i mungojnë leksionet e tij 90 minutëshe.

Herën e fundit që u shfaq ishte më 20 shkurt, në tarracën e Kryeministrisë, duke dhënë urdhra me celular për përhapjen e forcave të Policisë në pritje të marshimit të demokratëve. Afërmendsh që atje sipër kishte pamje më të mirë e mund të jepte urdhrat e duhur, por s’arrita të kuptoj se pse drejtin luante trupin, krahun, dorën e kokën ndërsa fliste në celular majë tarracës. Shefat e Policisë, aty poshtë në bulevard, mund ta dëgjonin nga celulari, por s’mund t’ia shihnin lëvizjet. Mister!

Me siguri edhe ëndrrat i sheh duke komanduar Policinë, inspektoratet, Ushtrinë. Ndoshta, ndoshta edhe Qeverinë, por këtu zgjohet dhe ëndrra ndërpritet.

Ndaj, këto kohë, mbrojtjen dhe propagandimin e suksesteve Rilindëse në rend e siguri e kanë marrë përsipër ministrat pa portofol dhe vetë Kryeministri.

LAJMI I MIRE

Policia ka vullnet e forcë ta luftojë krimin. Rilindësit e urdhëruan të merrej me informalitetin. Situata shkoi për drej. Dëshën s’dëshën, hoqën dorë.

Këto ditë Policia është rikthyer te lufta kundër kriminalitetit. Po përpiqet. Suksesi kundër kriminalitetit kërkon kohën e vet, inteligjencë, teknologji, fonde.

Mos iu ngatërroi Policisë nëpër këmbë se e gjen vetë mënyrën se si ta luftojë krimin. Mos e pengoni. Mos e keqorientoni. Mos e mbushni me militantë. Kujdes me të inkriminuarit që penetronë në radhët e saj përmes partisë, tarafit, parasë.

Mbështeteni Policinë. Ju, ne, të gjithë.

Nëpër labirinthe e terrorit

Vetëm ga mesi i shtatorit e deri në fund të shkurtit në të gjithë vendin kanë ndodhur 26 shpërthime me eksploziv, dhe në shumicën e rasteve kanë patur pasojë fatale për objektivin e atentateve. Pre e sulmeve me eksploziv kanë qënë mjaft të pafajshëm, ku atentatorët po shfrytëzojnë situatën e përçarje politike me një opozitë që ka kushtëzuar edhe pjesëmarrjen në parlament si kusht për abrogimin e ligjit për nëpunësin civil, ku sipas saj qeveria Rama po sulmon opozitarët duke i shkarkuar nga puna thjesht për motive politike. Edhe për shifrat e terrorizmit me lëndë plasëse pozita dhe opozita kanë shifra të ndryshme. Në fakt, sidomos natën, shpërthejnë shumë

kapsolla detonatore edhe pa objektiv të caktuar, duke i hedhur në rrugë, apo gjate ecjes me makinë. Njerëzit janë terrorizuar dhe situatë i ngjason një gjëndjeje terrori, thua se Shqipëria është në luftë. Edhe tritoli i tillë ka arritur të shënoji viktima, ndërsa objektivi kryesor i tritolvënësve është përditë shënjestër e hakmarrjeve e larjeve të hesapeve. Një shpërthim i fuqishëm me datën 2 shkurt 2014, në orën 03.00 të natës në Xhabije të qytetit verior Shkodër, ka terrorizuar disa njerëz.

Mësohet se ka qënë një kapsollë detonatore e futur në tritol që ka shpërthyer, ku sipas dëshmitarit Y.S ka patur objektiv banesën e shtetasit Riza Halluni. Aty, ka patur deme materiale, por jo viktima. Y.S është i afërm i R. Hallunit dhe shton se i sulmuari me tritol është person



pa asnjë problem, por fatkeqesisht ka një ngatërresë, pasi nipi i tij, A. Nurja ka vranë më datën 10 janar 2012 të quajturin B. Ndoja dhe pikërisht për atë akt ai sot vuan dënimin me 10 vjet burg. Por këtu nuk pyet askush për ligj dhe gjëndet si kod nderi Kanuni mesjetar i feudali Lek Dukagjini, ku haku merret në gjithë fisin. Gjithsesi, pak ditë pas kësaj ngjarjeje, Riza Halluni nuk gjëndet askund, njëlloj sit ë afërmit e nipit të tij A. Nurja. Ne thjeshtë arritëm të sigurojmë fotografinë e viktimit pa faj Riza Halluni dhe askush nuk të jep të dhëna më shumë. Në fakt edhe shifrat zyrtare janë të mjegullta. Zëdhënësja e opozitës Laura Vorpsi i ka shpeshuar akuzat ndaj qeverisë për fshehjen e akteve kriminale me tri-



tol. Por edhe ajo që pranon vetë policia është teper tronditëse Në analizën e bërë për muajin shkurt të këtij viti, rezultojnë se gjatë kësaj periudhe janë shënuar tetë raste vrasjesh me dhjetë viktima. Sidoqoftë policia deklaroi se kjo situatë të paktën është më pozitive se e njëjta periudhë e vitit që shkoi.

Redaksia

Nga dallohet shtypi serioz nga ai më pak serioz?

nga MUSTAFA NANO

Ishte interesante të vije re pardje reagimin e shtypit botëror pasi fotografi francez, Pascal Rostain lëshoi bombën në radion 'Europe 1', duke thënë se "Obama ka një lidhje jashtëmartesore me këngëtarën Beyonce". Në fakt, ai tha shumë më tepër se sa kaq, tha se "të martën, dmth dje, do duhej të lexonim gazetën amerikane Washington Post, ngaqë kjo gazetë do të publikonte provat që demonstroi këtë liaison". E marta iku, dhe lajmi i paralajmëruar prej paparacit në fjalë doli një rrenë e madhe. Washington Post-i nuk kish në faqet e veta asgjë të këtij lloji.

Duhet thënë se gazetat serioze nuk ranë në grackën e ngritur nga fotografi që vinte dorën në zjarr se gjithçka ishte e vërtetë. As që i dhanë hapësirë çaprashitjeve të tij. Nëse do t'i jepnin pak hapësirë nuk është se do të bënin ndonjë mëkat; paparaci kish kredenciale të mira për të dhënë lajme të tilla; ish po ky që, nëpërmjet fotove të shkrekura rrugëve të Parisit, nxorri në shesh lidhjen e Presidentit

francez François Hollande me aktoren Julie Gayet. Por të përditshmet serioze e injoruan. E njeri The Guardian, The Independent, Le Monde, Frankfurter Allgemeine Zeitung, Süddeutsche Zeitung, El Pais, El Mundo, etj. Veç nja dy gazeta franceze dhe nja dy italiane e hëngrën karremin. Ndërsa gazetë amerikane as që bëhej fjalë të merreshin me këtë lajm. Vetë Washington Post-i, që u hamendësua si regjia e 'përbetimit' antipresidencial, nuk zhgënjeu me qëndrimin e vet. Më në pikun e bujës që provokoi fotografi francez, dikush në emër të saj u mjaftua të thosh, se "ne nuk e kemi zakon të përgatisim artikuj të këtij lloji". Kaq. Dhe me këtë qëndrim u la të kuptohej jo vetëm që Washington Post-i nuk ish qendra e 'përbetimit', por edhe që ajo gazetë nuk e ka praktikë punë të fokusohet më tepër se sa duhet në çështje të tilla, dhe nuk është e prirur ta gjykojë një President amerikan mbi bazën e jetës së tij private.

Gazetat serioze, përfshirë ato franceze, bënë në thelb të njëjtën gjë edhe në rrethana të 'aventurës' së Presidentit francez, Hollande. Ok, informuan mbi faktin, madje çdo ditë, por nuk është se u ndalën për të gjetur në këtë histori ndonjë arsye për ta kryqëzuar njeriun më të fuqishëm të Francës. Dhe me këtë sjellje, kanë për-

çjellë mesazhin: Të zgjedhurit, sidomos kur janë me shumë pushtet, mbahen gjithë kohën nën vëzhgim, vlerësohen edhe me kriteret morale, por gjykohej para së gjithash mbi bazën e kontratës që ata kanë lidhur me zgjedhësit. Shtypi serioz e ka bërë me kohë të vetën këtë sjellje.



KE foli shqip: Në qershor 2014 (s') do pranoheni kandidatë të BE-së

Deri gjashtë muaj me parë populli dhe politika kanë ecur kundër njëri-tjetrit dhe as që bëhej fjalë për një dakordësi të Bashkimit Europian për pranimin e Shqipërisë si vënd kandidat. Vlerat dhe integriteti perëndimor as janë synuar, as janë mënduar nga politikbërësit tanë dhe as janë kërkuar seriozisht nga Bashkimi Europian. Vetëm gjashtë muajt e fundit qasja duket serioze pernga Brukseli dhe interesi i BE-së reflekton besim. Por gjashtë muaj janë pak dhe qeveria Rama ka fatin e keq që është qeveri post Berishë. Ky Berishë që çirret edhe më katolik se Papa në rrugën drejt BE-së, ka ecur indietro, duke instaluar presion politik dhe ekonomik mbi opozitën dhe duke ndërtuar një sistem të kontrolluar mbi drejtësinë, mbi policinë, mbi financat, ushtrinë, pronat, bizneset, diplomacinë... Ka ndërtuar modelin e një Demoni për Europën. Për këto e arsye të tjera jo më pak potenciale, KE, kësaj here, dhjetorin e shkuar, u detyrua të flasë shqip:

'Qeveria Rama ka filluar shumë mirë, por duam prova konkrete deri në qershor 2014. Pengesë është ish qeveria Berisha dhe korrupsioni...'

Kjo do të thotë që Shqipëria u pranua kandidate për në BE për këto tre muaj, pra deri në dhjetor, por nuk u pranua dhe zor të çelë atë derë pa luftuar seriozisht korrupsionin, pa ndërhyrë në sektorin e pronave ku tjetërsimi i tokave publike dhe private është një skandal, si askund tjetër në Botë, ku sistemi i arsimit është një re-

zeze, ku bosët e krimit jo vetëm ekonomik, janë të veshur me helmata politike.

Korrupsioni në fakt është kudo nëpër gjykata dhe tre muaj ishin pak e ndoshta do duhet kohë më e gjatë se edhe pas qer-

Alexander Arvizu, kur u shpreh qartë, shqip:

'Shumë prokurorë e gjykatës e kanë vëndin në burg.'

Në fakt, nga verifikimi i ndërtimeve pa leje, apo me leje në ambiente publike



shorit 2014 të marrin dënimet e t'u sekuestrohen pasuritë të tyre pushtetarëve që nisën rrugën me 'panolina' nëpër këmbë e sot janë milionerë. Ndoshta drejtësia kërkon gjyqtarë e prokurorë të huaj, se zor hajduti të dënoi hajdutin. Këtë tha me fjalë të tjera ambasadori amerikan

atë tjetërsuara më dokumente falso, ku pas çdonjërit fshihen milionat e eurove, askush nga pronarët nuk del pronar, por të zotët na qenkan pushtetarët, politikanët, hetuesit, prokurorët, gjykatësit, drejtorët, kryekomunarët...

Pra këtë radhë KE e tha mesazhin shq-

ip: Qeveria Rama kërciti në derë të BE-së, por nuk duhet të punoi si qeveria Berisha. Të mos harrojmë, në 2005-sën Berisha u rikthye në pushtet pikërisht me sloganin: 'Me duar të pastra.' Fatos Nano dhe shumë të akuzuar nga ai për korrupsion,

shumë shpejt u bënë aleatë të tij. Pra, ju e shihni që nuk ishin kushte as tre ligjet, as legalizimi i të drejtave të komunitetit gay, asgjë që trumbetonte Berisha për tu pranuar kandidatë në BE. Qeveria aktuale në fakt e ka më të vështirë dhe tani që Europa e ka marrë seriozisht tërheqjen e Shqipërisë në familjen që i takon, 'gurët' e Ramës nuk do godasin aty ku goditën 'gurët' e Berishës. Berisha, sa kohë ishte në pushtet, nuk ishte shumicë. Me 'gurë' në xhep, si pelegrin fallco, megjithëse edhe djali edhe vajza i faleshin pesë herë në ditë në xhami, në vënd të gjuante 'djallin', pra korrupsionin, padrejtësitë, gjuajtji kundërshtarët politikë dhe tërë ata që aspironin model qeverisjeje dhe jetese europiane. 'Gurët' e Ramës duhet të qëllonjë në shenjë, edhe kundër të korruptuarve në kampin e vet, pra kundër 'djallit' që KE do e vlerësoi në qershor 2014. Duhet

edhe të reflektoi se është shumicë, duke ngritur edhe politikën në stadin e qeverisë, që normalisht e ka lart, më lart se asnjëherë tjetër në tërë historinë e shtetit shqiptar.

Sokol Pepushaj

PËRSE DEPUTETËT KËMBËNGULIN TË SHKELIN LIGJIN?

Jo shumë kohë më parë, në media u raportua ndëshkimi me gjobë nga policia rrugore i disa deputetëve që parkonin makinat e tyre në trotualet përballë godinës së kryesisë së Kuvendit. I pata parë vajzat police që vendosnin fletët e gjobave mbi xhamat e veturave të përfaqësuesve të sovranit, sepse kishin shkelur një ligj të sovranit. Një dukuri shpresëdhënëse e këmbënguljes për ta zbatuar ligjin barazimtarisht pa bërë dallime se kush është shkelësi i tij. Dhe për disa kohë, makinat nuk u panë të parkuara mbi trotualet. Por dy ditë më parë, ndërsa kaloja pranë Kryesisë, pashë se trotualet ishin, si kurrë më parë, plot me vetura deputetësh. Duka është thelb dhe thelbi shfaqet. Sado e vogël në dukje, dukuria shpreh atë që është ngërçi themelor i ndërtimit të shtetit në Shqipëri, moszbatimi i ligjit në përplasje me një hierarki të tërë shtresash sociale që këmbëngulin për dhunimin e tij. Por kur pjesë e kësaj hierarkie transgresore bëhen edhe vetë ligjvënësit, shteti do ta ketë shumë të vështirë, në mos të pamundur të ngrihet. Hë mo se një shkelje e vogël është! Edhe më keq që është e vogël. Se kur deputetët shkelin ligjin për diçka që nuk kushton asgjë ta zbatosh, si mund të pritët të zbatojnë ligjin për gjëra më të mëdha, që u kushtojnë shumë?!

Në një rrafsh më të gjerë, problemi që po shqyrtojmë ka të bëjë me mungesën e kulturës së zbatimit të ligjit në shoqërinë shqiptare. Hegel, shkruan diku, se qytetërimin Perëndimor nga ai Lindor e dallon raporti që kanë me moralin dhe me ligjin. Dihet që morali, ndryshe nga ligji, ka të bëjë me disa rregulla që njeriu i zbaton, përgjithësisht, me vullnetin e vet, pa imponim nga jashtë. Janë, si të thuash, të brendësuar në arsyen e tij. Hegeli vërente se, ndërsa te perëndimorët shquhej tendenca që edhe ligjin ta shndërronin

gradualisht në moral, te lindorët edhe morali kishte tendencë të shfaqej si një rregull i jashtëm, që i imponohej njeriut nga jashtë. Shkurt, ndërsa në Perëndim tendenca ishte që ligji të shndërrohej në moral, në Lindje morali kishte tendencë të shfaqej si ligj. Ne shqiptarët, pavarësisht vokacionit (më saktë sloganeve) për integritet me Perëndimin jemi, në rrafshin që shqyrtojmë, ende një shoqëri me një mendësi të theksuar Lindore, në të cilën shndërrimi i respektimit të ligjit në etikë, thuajse nuk ekziston si prirje. Por falë edhe pandëshkueshmërisë kronike, po humbet edhe kuptimi i ligjit si një forcë që i imponohet njeriut nga jashtë. Ligji shfaqet i pafuqishëm, i shpërfillur. Ndaj tendenca e dhunimit të ligjit thuajse ka fituar të drejtën e qytetarisë. Kush shkel ligjin jo vetëm nuk ndëshkohet,



por pasurohet, madje bën edhe karrierë. Kush nuk dhunon ligjin, humbet shanset e përparimit dhe begatisë. Shteti është kthyer me kokë poshtë. Në fakt, në këto dy dekada, thuajse gjithçka, karriera, pasuria, lavdia, pushteti janë themeluar, më së shumti, mbi shkeljen e ligjit.

Shkelja e ligjit nga deputetët që parkojnë në trotuar, është tregues kulmor i përmbyesjes së raporteve që shoqëria mban me ligjin. Në media ka dalë edhe një lajm se, pas marrjes së gjobave nga policia, deputetët të të gjitha ngjyrave i ishin qarë edhe Kryetari të Kuvendit, Ilir Meta. Shtrohet pyetja: Mos vallë edhe fakti që makinat nisen të parkohen përsëri përballë Kryesisë së Kuvendit në kundërshtim me ligjin është shfaqje e pushtetit mbi ligjin që na paska Kryetari i Kuvendit? Pyesim, sepse nuk jemi të sigurt që ka ndodhur pikërisht kështu. Por po të jetë kështu, atëherë do të qe edhe më keq! Aspirata e shtetit ligjor nuk lejon që qoftë edhe një njeri i vetëm, të ketë fuqi të qëndrojë mbi ligjin. Dhe politikanë e pushtetarë, që shpallin

në një komedi për europianët dhe në një tragjedi për shqiptarët.

Është kanceroze për shtetin që të tolerohet një dhunë kaq e hapur, kaq spektakolare e ushtruar kundër ligjit nga ata që janë votuar prej shqiptarëve që ta mbrojnë atë. Është shërbimi më i keq që mund t'i bëhet vendit në këto kohë, kur ai ka nevojë të ngrejë në piedestal ligjin e poshtëruar. Krahas aktivizimit të drejtësisë së pavarur, duke i dhënë fund pandëshkueshmërisë, edhe elita shoqërore dhe politike duhet të japë kontributin për lartësimin e ligjit, duke dhënë shembullin e saj. Mjerisht ajo po bën të kundërtën. Por pikërisht pse tolerimi i shkeljes së ligjit shndërrohet në kancer që ha shtetin ligjor, kudo në Perëndim, opinioni publik dhe institucionet janë ekstremisht intolerantë veçanërisht me zyrtarë të lartë shtetërorë, kushdo qofshin ata. Tetorin e kaluar, Hillari Clinton u dënua në Londër me 80 paund gjobë nga një polic, sepse stafi i saj nuk kish paguar tarifën e parkimit të makinës. Dhe përse nuk duhet ta gjobiste polici londinez edhe një figurë me përmasa të tilla, kur për ligjin janë njësoj të gjithë? Po të kish guxuar të vendoste një gjobë të tillë ndonjë polic në Tiranë, rrezik të shpallej provokator dhe prishës i miqësisë shqiptaro-amerikane. Policët në Shqipëri janë përherë nën kërcënimin e arrogancës së të fortëve me pushtet, të cilët mezi ç'presin që të qenët "ndryshe" nga qytetarët e zakonshëm ta demonstrojnë te të qëndruarit mbi ligjin. Ashtu si Akilin nuk e kapte shigjeta, edhe këta gjysmëperëndi të politikës nuk i kap ligji. Vërtet të tillë zyrtarë e deputetë janë ndryshe nga qytetarët e tjerë. Ata nuk janë qytetarë!

se kanë për objektiv ndërtimin e shtetit ligjor, duhet ta faktojnë devocionin e tyre ndaj zbatimit të ligjit edhe me vetë shembullin e tyre. Ligjvënës që shkelin ligjet që ata vetë i kanë aprovuar në emër të sovranit popul?! Tolerime të tilla e kanë shndërruar shtetin ligjor në Shqipëri

Hakmarrja mesjetare i rrezikon jeten të miturit Saimir Beqiraj

Është pikërisht konflikti për pronën, tokën, që detyron të miturin Saimir Beqiraj të braktisë vëndin tij për të shpëtuar jetën. Në Shqipëri janë regjistruar mijëra të vrarë si rrjedhojë e konflikteve për pronën, pasi shteti postkomunist ende nuk ka zgjidhur problemin e pronësisë. Janë disa burime që dëshmojnë për gazetën se i mituri Saimir Beqiraj nga fshati Dobraq i qytetit të Shkodrës, u detyrua të largohej nga Shqipëria, pasi i rrezikohet jeta. I mituri Saimir Beqiraj, në mungesë të mbështetjes së babait të tij F. B., i cili është emigrant në Itali që në vitin 2000, u detyrua të braktisë familjen e tij, duke e lënë në mëshirë të fatit. Gjakmarrja mesjetare është një plagë shumë e rëndë e shoqërisë sonë, ku mijëra të ngjuar kalojnë ditët me shpresë se plumbi i hakmarrjes nuk do ti gjejë edhe sot. Një tragjedi e habitshme e shekullit të 21-të është historia e dhimbshme e këtij djaloshi të lindur



më 21 korrik të vitit 1998 në Shkodër, nga një baba fermer dhe një nënë shtëpiake. Jeta e këtij fëmijë u kthye në ferr që në moshë të vogël, duke u detyruar të përshtatej me një jetë ndryshe nga moshatarët e tij, në ikje drejt rrugëve pa kokë, në gjetjen e ndonjë mundësie që të mos e marrë plumbi i hakmarrjes, si shumë moshatarë të tjerë që janë vrarë megjithëse nuk kishin asnjë faj. Për të dhënë informacion më të detajuar rreth

kësaj historie që ka tërhequr vemendjen e shumë njerëzve, po botojmë një intervistë të dhimbshme të nënës së të miturit Saimir Beqiraj, të quajturës Esmë Beqiraj:

-Pyetje: zonja Esmë, ju na treguat se djali juaj i mitur ka rreth dy muj që është larguar nga Shqipëria. A keni komunikim me të?

-Përgjigje: Po, kam komunikuar me djalin tim dhe ai më ka thënë se është shëndosh e mirë. Kjo më qetëson disi.

-Pyetje: A mund ta dimë a ju ka treguar djali juaj se ku ndodhet?

-Përgjigje: Po, unë e di se ku ndodhet im bir, por më besoni, nuk mund ta bëj publike vëndndodhjen e tij, pasi ky informacion jam e bindur se e i rrezikon jetën, e për të shpëtuar jetëm iku.

-Pyetje: Pse mëndoni se mund ti rrezikohet jeta, pasi ne kemi qëllim të shpjegojmë se ai është një fëmijë i pafajshëm dhe të prekim në ndërgjegjen e atyre prej të cilëve ka frikë?

-Përgjigje: Oh, jam nënë, janë vrarë shumë shqiptarë, bile edhe fëmijë për konflikte edhe më të vogla, pastaj, personi me të cilin kunati im u grind e konflikti u rrit shumë, është në pozita të larta e ai është i aftë të bëjë gjithçka. Më kuptoni, nuk mund të them më shumë.

-Pyetje: A e keni denoncuar këtë ngjarje në organet e drejtësisë, dhe nëse po, si ka qënë reagimi i tyre?

-Përgjigje: Po, e kam denoncuar rastin në polici, por më perplasën në fytyrë këtë përgjigje: "Nuk kemi çfarë të bëjmë"

-Pyetje: Ju keni tre fëmijë dhe bash-

këshorti juaj jeton në Itali prej kohësh. Meqënëse jeta e djalit tuaj është në rrezik, përse ai nuk shkoi të jetojë me babanë e vet?

-Përgjigje: Ju më prekët shumë plagë me këto pyetje. Unë dhe ish burri im i kemi shkëputur kontaktet që nga viti 2005, pasi ai më tradhtoi keq, duke krijuar një familje tjetër në Itali. Megjithëkëtë, ish burri im, në qershor 2013 e mori djalin për pak muaj atje, por e dëboi shpejt me pretekstin se kishte një familje tjetër dhe nuk mund ta ndihmonte.

-Pyetje: Do donim një përgjigje më konkrete, përse e keni kaq frikë personin që ju ka kërcënuar?

-Përgjigje: Sepse është një person që ka mbështetje të fortë politike.

Kjo intervistë e kësaj nëne të trishtuar flet shumë. Flet për padrejtësi shoqërore, tregon se sa e pavlerë është jeta e njerëzve të thjeshtë, por edhe për korrupsionin në organet e drejtësisë, korrupsion të cilin e lakojnë jo vetëm organizmat ndërkombëtare, por e pranojnë edhe presidenti i republikës Bujar Nishani edhe kryeministri Edi Rama dhe prapëseprapë asgjë nuk ndryshon, duke e lënë shoqërinë shqiptare në kushtet e një shteti pa ligje dhe me të drejta të diferencuara, ku i forti e ha të dobëtin dhe ku të pafajshmit bëhen viktime dhe kriminelët gjenden jo vetëm të lirë në rrugë, por edhe si ligjvënës në Parlament.

Redaksia

Katër më të fortët e Tiranës – Ku po shkon Shqipëria?

Nga Lorenc Vangjeli

E djeshmja ka dëshmuar vazhdimisht se nuk mund të vesh bast të sigurt për atë çfarë mund të ndodhë në të ardhmen me politikën shqiptare dhe vetë Shqipërinë. Çfarë duket e sigurt sot, kthehet në të kundërtën e saj nesër. Megjithatë, “The Economist Intelligence Unit”, një agjenci e njohur britanike, e ka bërë një gjë të tillë. Ka vënë “bast” me parashikimet e saj për të nesërmen e Shqipërisë. Duke nisur me bindjen se Shqipëria mund të marrë statusin e vendit kandidat për në BE në qershorin e këtij viti, se reformat e pritura nga qeverisja e re e majtë e vendit kanë shumë gjasa të jenë të suksesshme, se Lulzim Basha do ta ketë të vështirë të krijojë figurën e liderit të PD-së, se Sali Berisha do të vazhdojë të jetë një figurë e dorës së parë në atë parti dhe se Ilir Meta do të vazhdojë të jetë Kingmaker-i i politikës vendase.

Raporti bën një numër parashikimesh për të nesërmen e vendit, raportet e reja politike të krijuara mbas zgjedhjeve të 23 qershorit dhe ndryshimit të ngjyrës së qeverisjes dhe trendin e ekonomisë vendase, të parë dhe në plan rajonal.

Në pjesën e parë të raportit afrohen të dhëna të përgjithshme për vendin, të cilat shkojnë që nga shënimi i sipërfaqes së vendit, numri i popullsisë sipas censurit të fundit të vitit 2011 e deri tek monedha lokale dhe festat zyrtare. Plot 11 të tilla. Madje duke theksuar edhe se nëse dita e festës zyrtare bie në të ditë të shtunë ose e dielë, një tjetër ditë pune bëhet pushim në javën pasardhëse.

Në kapitullin “Struktura politike”, thuhet se Shqipëria ka miratuar me referendum në 22 nëntor të vitit 1998 Kushtetutën e re të saj, e cila ka hyrë në fuqi një javë më pas, në 28 nëntor.

Përmend numrin prej 140 deputetësh, zgjedhjet e mbajtura në 23 qershor 2013, datën 15 shtator 2013 si ditën kur u konstitua qeveria e re e koalicionit PS-LSI dhe jep emrat e gjithë kabinetit qeveritar, të kryetarit të Kuvendit dhe guvernatorit të Bankës së Shqipërisë.

Më pas afrohen të dhëna të përgjithshme për ekonominë për katër vitet e fundit, duke nisur me GDP-në e ndryshimet e saj në vite duke nisur me 2009-ën.

Specifikohet se peshën kryesore të GDP-së e zë agrikultura me 17.8 për qind, industria me 10.1 për qind e më pas, ndërtimi me 9.7 për qind e transporti me 5.1 për qind. Gjithë shërbimet e tjera zënë një peshë specifike prej 24.3 për qind.

Totalin i eksporteve shqiptare në masën 35.7 për qind e zënë mineralet, karburantet dhe energjia elektrike dhe po këto zëra, zënë dhe shumicën e importeve me 20.9 për qind. Shqipëria eksporton gjithashtu tekstilë dhe këpucë, kryesisht produkte të industrisë fason në masën 29.1 për qind, materiale ndërtimi, përgjithësisht çimento, ushqime, pije të ndryshme dhe duhan. Makineritë zënë vendin e fundit në listë me vetëm 3.6 për qind të eksporteve dhe vendin e dytë në listën e importeve me 18.5 për qind.

Eksport-importet e Shqipërisë, si destinacion të parë kanë Italinë fqinje, Span-

jën, Kosovën dhe Turqinë vetëm eksportet dhe Greqinë, Kinën dhe Gjermaninë importet. Këto të dhëna janë siguruar për “The Economist” nga një numër burimesh të ndryshme dhe të pavarura, nga Banka e Shqipërisë, Instituti i Statistikave dhe burime të tjera.

Situata politike

“Qeveria e re, e cila ka marrë 83 mandate parlamentare nga 140 gjithsej... ka një mandat të fortë dhe një kohezion më të madh ideologjik, krahasuar me qeverinë paraardhëse”, shkruhet në raport.

“The Economist” analizon se kjo shumicë ka mundësi të qarta për miratimin dhe më pas edhe zbatimin në praktikë të legjislacionit për një sërë reformash, që përfshijnë luftën kundër korrupsionit, efikasitetin e administratës publike, rritjen e pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe

mendet se ai ka konsoliduar grupin e tij në lidhshme me PS-së dhe e ka rrethuar veten me një brez të ri politikanësh dhe aktivistësh, një pjesë e të cilëve i ka thirrur edhe si anëtarë të kabinetit qeveritar.

Raporti e përmend kryetarin e Kuvendit dhe kreun e LSI-së si aleatin strategjik të PS-së në qeverisje. Ilir Meta, quhet si një ish-kryeministër socialist, i ndarë nga PS-ja në vitin 2004 kur themeloi LSI-në dhe konsiderohet si një nga shkaqet që socialistët patën dy humbje të njëpasnjëshme elektorale.

“Meta e rifitoi (në vitin 2013) pozicionin e tij si kingmaker, një rol të cilin ai e morri që mbas zgjedhjeve të vitit 2009”. Raporti konsideron se Meta do të kërkojë që partia e tij të trajtohet si partner i barabartë në koalicion.

“Kjo mund të krijojë edhe tensione në gjirin e koalicionit”.



përmirësimin e klimës së biznesit. Por gjithashtu, edhe shpejtimin e procesit të integritetit në BE.

Sipas raportit, në krahasim me të shkuarën, e ardhmja e reformave duket optimiste, por problemet shumë komplekse me korrupsionin gjerësisht të përhapur, mund të krijojnë, megjithatë, pengesa në zbatimin e tyre.

Rama, Meta, Berisha, Basha

Katër personazhet më të rëndësishëm të politikës shqiptare përmenden me emër në raport, nëpërmjet një CV-je të shpejtë dhe domethënëse.

I pari, Rama, një nga dy aktorët kryesorë të shumicës së re qeverisëse, vizatohet me disa linja të shpejta.

Është interesante të shihet se “The Economist” vë re, para së gjithash, profesionin fillestar të Edi Ramës dhe formimin e tij si artist përpara se të bëhej pjesë e politikës.

Sipas tij, Rama i provoi aftësitë e tij politike si një kryebashkiak i suksesshëm i kryeqytetit, Tiranës, kur përgjatë tre mandateve radhazi, 2000-2011 “...realizoi ndryshime spektakolare...”.

Vëzhgimi britanik nënvizon se, ndryshe nga Berisha në partinë e tij të cilën e drejtoi me dorë të hekurt për më shumë se dy dekada deri në dorëheqjen e tij, Rama e ka fituar pozicionin drejtues në PS duke u ndeshur me një mori sfidash përballë të vjetërve në parti. Në vitet e fundit, për-

Ndërsa duke gjykuar lidhshimin e opozitës, humbja elektorale e të cilës shënoi dhe fundin e një epoke 22 vjeçare me dorëheqjen e zotit Berisha, raporti parashikon vështirësi në krijimin e figurës së liderit nga pasuesi i tij, zoti Basha.

Basha shihet si një politikan me eksperiencë që ka mbajtur portofolin e tre ministrive të ndryshme në qeveritë e drejtuara nga zoti Berisha.

“Ish-lideri Berisha do të mbetet një figurë influente dhe me të gjitha gjasat do të jetë ai që do të udhëheqë zotin Basha në përpjekjet për të rikthyer popullaritetin e PD-së”.

Marrëdhëniet ndërkombëtare

Raporti kujton se integrimi evropian është një prioritet i politikës së jashtme shqiptare. Shqipëria ka aplikuar për anëtarësim në prill të vitit 2009, por për tre vjet Komisioni Evropian e ka bërë të qartë se “Shqipëria nuk ka qenë gati për të marrë statusin e vendit kandidat”.

Shënohet fakti se në vitin 2012 Shqipëria kreu një reformë elektorale dhe juridike që u pasua nga përmirësimi i rregullores së Kuvendit dhe ligji për administratën publike, çfarë ishin pika kyçe në kërkesat për integrimin evropian të vendit. Një vit më pas, zgjedhjet e përgjithshme të vëzhguara nga ndërkombëtarët, u konsideruan të mbajtura sipas standardeve evropiane. Një gjë e tillë solli si rezultat final rekomandimin pa kushte

të Komisionit Evropian në progres raportin për Shqipërinë, të tetorit 2013, në të cilin rekomandohej dhënia e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë.

“Ministrat e Jashtëm të BE-së në mbledhjen e 17 dhjetorit pranuan me shumicë rekomandimet e komisionit, por vendosën për një shtyrje të dhënies së statusit deri në qershor të vitit 2014 duke kushtëzuar atë me progresin e mëtejshëm të Shqipërisë në luftë kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar”.

“Ne presim që Shqipëria të bëhet një vend kandidat i BE-së në mes të vitit 2014”, paralajmëron raporti i “The Economist”. Megjithatë, Shqipërisë i nevojitet të plotësojë edhe pesë kushtet e vendosura nga Komisioni Evropian, përpara se të nisë bisedimet për pranimin në BE. Këto kushte lidhen me reforma të mëtejshme që lidhen me administratën publike, gjyqësorin dhe luftën kundër korrupsionit, krimin të organizuar, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfshi dhe të drejtat e komunitetit rom.

Shqipëria do të vazhdojë të forcojë lidhjet e ngushta me Kosovën. Sipas raportit, Tirana zyrtare e ka distancuar veten nga nacionalistët që kërkojnë “Shqipërinë e madhe”, bashkimin e popullsisë shqiptolëse në rajon në një shtet të vetëm.

Ekonomia

Gjendja ekonomike quhet trashëgimi e vështirë; me një rritje të ngadaltë të GDP-së në dy vitet e fundit, 2012-2013. Shënohet rënia serioze e mbledhjes së të ardhurave fiskale gjatë vitit elektorale, vit gjatë të cilit, deficitin buxhetor shpërtheu. Nënvizohet fakti që PD nuk kishte ripërtërirë marrëveshjen me FMN, që skadoi në 2009 dhe fakti tjetër që borxhi publik ishte rritur në vitet e fundit. Përkundrajt këtyre, qeveria e re ka përqaftuar një strategji afatmesme për uljen e deficitit buxhetor dhe reduktimin e borxhit publik duke kërkuar dhe ndihmën e FMN-së. Ndihma nga FMN konsiderohet e nevojshme në kushtet kur eksportet shqiptare dhe remitancat e emigrantëve shqiptarë nuk parashihen të rriten.

Raporti e konsideron si një përpjekje për ta bërë më miqësor imazhin përpara investitorëve të huaj propozimin e bërë në mesin e tetorit të vitit të kaluar për zgjidhjen përmes bisedimeve bilaterale të mosmarrëveshjeve me grupin CEZ, të cilit ju hoq licenca e operimit në Shqipëri nga qeveria Berisha. CEZ ka kërkuar arbitrazh ndërkombëtar në maj të vitit 2013. Raporti jep gjithashtu konsiderata për politikën fiskale, mometare dhe rritjen e pritshme ekonomike. Rritja anemike e vitit 2013 shihet e lidhur edhe me recensionin në eurozonë dhe sidomos me problemet e Italisë dhe Greqisë, dy vendet me të cilat Shqipëria është partner i ngushtë ekonomik. I gjithë raporti është një pasqyrë e asaj që pritet të ndodhë në Shqipëri në këtë vit. Ai ka një rëndësi kritike sepse në një mënyrë apo një tjetër, është dhe një guidë e besueshme edhe për investitorët e huaj, por dhe për marrëdhëniet bilaterale të Shqipërisë me partnerët ndërkombëtarë. Mbetet të pritet sesa ai do të verifikohet në praktikë.

Të majtët, të djathtët dhe fundamentalistët

Nga Fatos Lubonja

Po “fus hundët” edhe unë në një debat që më tërhoqi vëmendjen, pasi me temën e tij jam marrë jo pak. E kam fjalën për komentet që ngjalli batuta e Ramës mbi të majtët dhe të djathtët në Shqipëri, që u pasua nga një shkrim i Fevziut kundër tij. Kryeministri, duke cituar Bernard Shaw-n, tha se “jo të gjithë të djathtët janë budallenj, por shumica e budallenjve janë djathtas” (duke nënkuptuar se këtë shumicë në Shqipëri e gjen te PD). Fevziu, në një shkrim të botuar në “Panorama”, pasi i kujtoi se edhe vetë dikur ka pretenduar se është i djathtë, i përmendi një thënie të Eleanor Roosvelt (që gabimisht ia atribuoi Shawt), sipas së cilës “mendjet e mëdha merren me idetë, mendjet mesatare me ngjarjet dhe mendjet e vogla me njerëzit”. Sipas Fevziut, të djathtët shqiptarë janë marrë me ide, jo me njerëz, siç janë marrë të majtët dhe siç bëri edhe Kryeministri vetë me batutën që lëshoi – (por ai nuk na tha se çfarë është, sipas tij, Berisha, sepse, nëse ka njeri që është marrë me njerëzit, është ish-kryeministri). Më intereson ky debat pasi më ndihmon të argumentoj një tezë së cilës i mëshoj prej kohësh, sipas së cilës në Shqipëri ende nuk ka “të majtë” dhe, për pasojë, as edhe “të djathtë” – pasi këto nuk mund të ekzistojnë pa njëra-tjetrën – në kuptimin libertar.

Por përpara se të përgjigjem se çfarë janë këta tanët, le ta marrim me radhë arsyetimin duke nisur me Bernard Shaw-n. Sigurisht, çdo thënie ka kontekstin e vet. Për të kuptuar se në ç’kontekst e ka thënë Shaw atë që citoi Rama, do t’i referohesha një thënieje të një bashkëkohësi të Shaw-t, po aq i rëndësishëm sa ai, edhe ai i majtë, Bertrand Russell-it. Ai thotë është pak a shumë një ide të tillë: në këtë botë ka dy kategori njerëzish, ata që i adoptohen botës ku jetojnë dhe ata që kërkojnë ta adoptojnë botën sipas vetes/ideve të tyre – dhe prandaj bota u përket këtyre të dytëve. Me fjalë të tjera – sipas Russellit – janë këta të dy të tjerë që sjellin ndryshimin e botës. Dhe ashtu siç e kuptoj unë Russell-in (duke e lidhur edhe me Shaw-un), këta, sipas tyre, janë të majtët, pasi, përgjithësisht, të majtët njihen si progresistë dhe të djathtët si konservatorë. E në këtë ndarje mendoj se ata kanë parasysh edhe politikanët, por mbi të gjitha mendimtarët e majtë e në përgjithësi njerëzit me qëndrim të majtë që, në kohën e tyre, kërkonin me ngulm të ndryshonin botën. Po t’i referohemi psikologjisë dhe sociologjisë, këtë që thotë Russell mund ta shprehim edhe duke interpretuar dy karakteristika psiko-sociale që ka qenia njerëzore. Njëra është ajo që quhet “sensi i adoptimit”, që është shumë i rëndësishëm te njeriu, pasi nëpërmjet këtij ai mbijeton (për mirë dhe për keq) duke iu përshtatur rregullave e ligjeve të shoqërisë e ambientit ku jeton. Madje thuhet se njeriu është qenia më e adoptueshme në botë. Por njeriu ka edhe atë që e quajnë “sensi i mundësisë”, që do të thotë aftësia e tij për të mos e pranuar realitetin, për ta ndryshuar atë, për të krijuar gjëra që s’kanë ekzistuar më

parë, për të ndryshuar botën me një fjalë – e që e ka v etëm njeriu dhe asnjë qenie tjetër në botë. Në sajë të këtij sensi ka ndodhur edhe evolucioni i shoqërisë njerëzore. Nuk ka dyshim se shumë njerëz të ndritur, që nga koha e Revolucionit Frëng e këtej, – kur lindi edhe e majta dhe e djathta – i përkasin kategorisë së progresistëve që kanë ndryshuar/transformuar botën.



Dhe këtu duhet të kemi parasysh se mendimi i Shaw-it i përket vazhdimësisë së Iluminizmit, që konsiderohet si moderniteti, që ka jo pak lidhje, por edhe diferenca, me postmodernitetin që jetojmë. E them këtë pasi moderniteti solli edhe shumë deluzione në ndërmarrjen e tij për të transformuar botën e se postmoderniteti lindi pikërisht si reagim apo korrigjim i gabimeve të modernitetit. Nuk mund të harrojmë p.sh. se kampionët e tillë të modernitetit, si komunistët, dolën shumë “budallenj” në përpjekjen e tyre për të ndryshuar botën në raport me konservatorët, edhe pse ëndrra e tyre u mbështet nga ndoshta shumica e mendjeve më të ndritura të shekullit XX, duke përfshirë edhe Shaw-un dhe Russell-in. Prandaj e kam vështirë ta them se cilët janë më të mençur, progresistët apo konservatorët. Personalisht preferoj qasjen e të parëve ndaj realitetit, si kërkim i çlirimit ndaj zgjedhave të tij, por them se, si shoqëri, kemi nevojë për mençuritë e të dyja kategorive, që janë të ndryshme e që, për fat të keq, mendoj se te ne, më së shumti mungojnë.

Vetë fakti se në krye të PD-së deri tani kemi pasur një ish-komunist dhe në krye të PS-së kemi një ish-demo-kristiano-islamk, flet jo pak për këtë. Unë i mëshoj idesë sipas së cilës në Shqipëri, pas viteve ‘90, kanë lulëzuar dy të djathta, por jo të stilit libertar, por të stilit fundamentalist. Le të përpqim ta argumentoj këtë duke iu referuar disa ideve e kyçe që dallojnë sot e kësaj dite të majtën nga e djathta. Së pari, duke pasur parasysh “sensin e adoptimit” (të lidhur më shumë me konservatorët) dhe “sensin e mundësisë” (të lidhur më shumë me progresistët), mendoj se partitë që lindën me pluralizmin nuk kanë dallim midis tyre. Si Partia Demokratike në vitin 1991, edhe Partia Socialiste në vitin 1992 (pra në një diferencë kohe të papërfillshme) iu adoptuan menjëherë ideologjisë së djathtë neoliberaliste që kishte triumfuar në Perëndim pa asnjë lloj dyshimi. Po ashtu ato nuk u përpoqën të ndryshojnë kulturën e zhvilluar përgjatë një historie të tërë në mungesë lirie që ka zhvilluar te ne vetëm sensin e adoptimit, që sintetizohet në thënien/moto të shqiptarit: “Bëj siç bëjnë”. Ato më së shumti iu adoptuan mendësinë e popullit shqiptar të kultivuar në kohën e Hoxhës e më parë në kërkim të votës së shumicës. Mjaft të kesh parasysh gjuhën e Sali Berishës që vazhdon sot e kësaj dite t’i gjykojë njerëzit me familje, vetëmburrjen tonë në vend të sensit kritik dhe vetëkritik, kultin e të fortit dhe të dhunshmit etj. Ose faktin se si Edi Rama i braktisi të gjitha idetë e tij antikonformiste të para vitit ‘97 për

t’iu përshtatur turmës së votuesve socialistë.

Pa dyshim ka pasur edhe ndryshime kulturore po të kesh parasysh p.sh. hartimin e një kushtetute të standardeve perëndimore, instalimin (nga pikëpamja formale) të institucioneve demokratike, heqjen e dënimit me vdekje, heqjen e dënimit për homoseksualitet, por gjithkush do të pranojë se këto janë bërë nën diktat perëndimor apo për t’iu përshtatur Perëndimit, dhe jo nën shtytat progresiste të partive që kemi në vend. Së dyti, në këtë ravë, unë gjykoj se një kriter tjetër që dallon “të majtët” nga “e djathta” dhe që besoj se e ka pasur parasysh Shaw, është qëndrimi ndaj nacionalizmit dhe luftës apo paqes. Sikurse dihet, të majtët në emër të një bote tjetër pa kolonializëm dhe pa shfrytëzim kapitalist hodhën parullën “proletarët s’kanë atdhe” dhe janë shprehur kundër luftës në emër të paqes. Përsëri kemi të bëjmë me një kërkesë për ndryshim të botës. Edhe në raport me këto v lera të së majtës, sigurisht të riformuluara në kohën tonë, te ne nuk kemi dallim midis të ashtuquajturve “të majtë” dhe “të djathtë” shqiptarë. Sikurse e kam shtjelluar edhe herë tjetër, të gjitha partitë tona ruajtën nacionalizmin që kishte kultivuar Hoxha në ideologjinë nacional-komuniste të pushtetit të tij, duke zëvendësuar mekanikisht komunizmin me europianizmin. Po ashtu ato kanë qenë përherë të gatshme të shkojnë të gjitha së bashku, pa dallim idesh, në luftërat që hapte Amerika, madje edhe përpara vetë amerikanëve. Së treti: gjykoj se një kriter tjetër që ka pasur Shaw është qëndrimi ndaj pabarazisë ekonomiko-sociale, qenia si të thuash e të majtëve me shtresat e varfra, për emancipimin e tyre, kundër idesë të pranuar gjerësisht nga të djathtët konservatorë se pabarazia është gjendje “natyrore” apo e natyrshme e njeriut. Edhe në këtë aspekt, të ashtuquajturit të majtë dhe të djathtë në Shqipëri nuk kanë bërë dallim. E kanë demonstruar këtë si në retorikat e tyre politike, edhe në praktikë, madje në këtë të dytën edhe më shumë po të kesh parasysh se deri vonë Partia Socialiste ka pasur numrin më të madh të të pasurve në Parlament.

Prandaj gjykoj se t’i ndash politikanët tanë në kategoritë “të majtë” e “të djathtë” dhe të kërkosh të aplikosh pastaj thënien e Bernard Shaw-t për t’iu diferencuar aty re aftësitë intelektuale, është pa v end. Por edhe të thuash se ata që vetëquhen “të djathtë” në Shqipëri janë marrë me ide kurse ata që vetëquhen “të majtë” me njerëz, nuk më duket aspak e vërtetë. Sipas meje, të dy ja palët janë marrë “me ngjarje” dhe “njerëz”, dhe jo me debat idesh, sepse idetë, siç u përpoqa ta shpjegoj, i kanë të njëjta. Madje do të thosha se për politikanët

tanë (kam parasysh ata që diktojnë frymën e partive, jo gjithkënd) nuk flitet për ide në shumës, por për ide në njëjës. Sepse pa mohuar disa ndryshime, ata i bashkon në gjërat kryesore, siç u përpoqa ta v ë në dukje, një qëndrim i djathtë ndaj realitetit shqiptar dhe mbi të gjitha fundamentalizmi. (Ndryshe do t’i quaja edhe proto-fashistë). Pse them fundamentalistë, ose ç’kuptoj me fundamentalistë? Po i referohem Zigmund Baumanit, i cili, duke folur për fundamentalizmin, citon një besimtar të devotshëm që thotë: “Sigurisht që ka shumë gjëra të ndryshme në këtë botë, por njëra është më e rëndësishme se të gjitha dhe, në momentin që ke pranuar atë, të gjitha problemet zgjidhen”. Fundamentalisti – vijon Baumani – e zgjidh kompleksitetin e botës dhe të problemeve të saj me një ide të vetme. Po besove të kjo ide, ajo disiplinon gjithë të tjerat: këtu qëndron forca e fundamentalizmit. Kjo bën që në një v end të ketë pastaj v etëm engjëj dhe demonë, të mirë dhe të këqij që luftojnë me njëri-tjetrin. Dhe për sa kohë që i ke fokusuar njerëzit te kjo luftë, të gjitha problemet e tjera njerëzore zgjidhen. Po të kesh parasysh realitetin tonë, fundamentalistët tanë e kanë fokusuar gjithçka në një ide të vetme: gjithçka për luftën për pushtetin dhe pasurimin e tyre. Dhe militantët e tyre i kanë fokusuar te ky problem me të cilin kanë “zgjidhur” të gjitha problemet e tjera. Kjo ka legjitimuar pastaj glorifikimin e vetes më një anë dhe demonizimin e kujtdo që s’është me ta, më anën tjetër.

Sot flitet aq shumë për mungesën, paaftësinë e klasës sonë politike për të bërë dialog, për të arritur konsensus. Por kjo është e pamundur pikërisht pasi kokat e tyre janë fundamentaliste. Ata nuk mund të merren me idetë, sikurse thotë Fevziu, sepse fundamentalistët njohin vetëm një ide, e cila nuk përmban dhe nuk lejohet të përmbajë asnjë dyshim. Kjo i pengon ata të pranojnë diversitetin, prandaj edhe të majtën dhe atë djathtën si dy rrugë të mendimit dhe veprimit politik. Prandaj ata s’mund të merren me ide, por v etëm me luftë ndaj njerëzve me sy nimin që të dejonizojnë ata që mendojnë pavarësisht prej tyre më një anë, si dhe të asgjësojnë aftësinë e militantëve të tyre për të menduar dhe dyshuar, më anë tjetër. Sepse mendimi dhe dyshimi janë gjërat të cilave e u tremben më së shumti fundamentalistët. “Shkaku kryesor i problemeve është se në botën ku jetojmë budallenjtë janë super të sigurt, kurse inteligjentët plot me dyshime”, thotë Bertrand Russell. Mëse e vërtetë. Shikoni sigurinë me të cilën sulmojnë njëri-tjetrin politikanët tanë, sigurinë e atyre që i ndjekin në luftërat fundamentaliste që provokojnë dhe gjejini vetë budallenjtë. Prandaj, sipas meje, politikanëve tanë do t’u shkonte më mirë një perifraxim i Bernard Shaw-t: Jo të gjithë fundamentalistët janë budallenj, por me siguri shumica e budallenjve janë fundamentalistë.

Na mbyti varfëria në kulturë

Nga Artan Fuga

Si varfëria kulturore ashtu edhe materiale do të vazhdojnë të mbisundojnë në një botë libri ku gjithçka është rrezuar nën peshën e ligjeve të hekurta të një ekonomie të mbetur e pakuptuar.

1. Libri shkencor: Vazhdon të jetë në versionin në letër shumë i dobishëm, por përhapet edhe në formën elektronike. Me formatin e vet jep dije shkencore, informacione enciklopedike, vlera artistike, etj. Pa librin shkencor nuk mund të ketë formimin shkollor të brezit të ri në të gjitha hallkat dhe nivelit e arsimit, duke nisur nga ai më i ulëti e deri te arsimit universitar. Libri shkencor nuk është vetëm tekst universitar apo manual shkollor, por edhe bartës kulture artistike, roman, vëllim me poezi, apo edhe album me piktura, si dhe përmbledhje studimesh, apo studim monografik që plotëson njohuritë e duhura në fusha të ndryshme specialiteti. Aktualisht, libri shkencor është i përdorur krejtësisht në mënyrë të pamjaftueshme nga studentët dhe shkollat dhe universitetet e rekomandojnë ende shumë pak te studentët edhe sepse pedagogët hezitojnë, edhe sepse një masë e madhe studentësh preferon një të mësuar folklorik, ora, por edhe për arsye financiare, xhepi i studentit nuk e mban të krijojë në bankat e shkollës një vëllim librash për bibliotekat personale.

2. Buxhet familjar për librin: Familjet shqiptare çojnë fëmijët në universitete për shkollim në mënyrë masive. Zakonisht edhe me dy fëmijë mesatarisht familja shqiptare i çon të dy në shkollë të lartë dhe madje deri në fund të formimit master. Por, kjo familje nuk është e bollshme në të ardhura, përkundrazi shpesh gjenden pak hollë, edhe kur dy prindërit punojnë, palë kur punon vetëm një prind, ose kur asnjëri prej tyre nuk punon. Buxheti i familjeve shqiptare për librin është thuajse i paqenë, por i kufizuar shumë kjo nuk ka asnjë dyshim. Shkoni aktualisht për vizitë në familjet shqiptare mesatare dhe shihni se në çfarë gjendjeje janë bibliotekat personale të shtëpive, nëse nuk janë fare të munguara. Atëherë bëjmë një llogari fare të thjeshtë: Dy fëmijë në shkollë të lartë, secili në çdo semestër nga 6 lëndë, në një vit 12 lëndë, nga 5 libra për lëndë, shumëzuar për pesë vite akademike dhe

pastaj me afro 1000 lekë të reja për libër që sot është çmimi i tij minimal, e gjitha kjo jep minimumi 60.000 lekë të reja, ose 6 milionë lekë të vjetra. Po në lekë të vjetra të mendohet një rrogë mesatare prej 300.000 lekësh të vjetra, do të thotë se për dy vjet paga e një prindi nuk duhet të përdoret as për gjë tjetër veçse për librat e fëmijëve nëse dëshiron që ata të shkollohen jo me një nivel të varfëri dijesh. Pra të mos llogaritet veshja, ushqimi i fëmijëve, udhëtimi i



tyre, as edhe paratë që duhen për të marrë një banesë me qira për ta. Kuptohet se nga të gjitha kursimet dhe shkurtime që duhen bërë në radhë të parë do të jenë librat. Mund të ketë edhe shumë arsye të tjera se përse nuk përdoren librat, por ka një arsye themelore, nuk ka parë, pra nuk ka këmbanë, si ta tregojë orën kisha?

3. Autor libri: Përgjithësisht autorët e librave shkencorë dhe universitarë janë pedagogë që marrin si pagë mesatare rreth 600.000 lekë të vjetra në muaj. Nëse një pedagog duhet të mbahet në një nivel të mirë shkencor, së paku po marrim se i duhen dy deri tre libra të mirë në muaj të blera nga jashtë. Përndryshe mbetet krejtësisht jashtë zhvillimeve të sotme shkencore. Atëherë 3 ose 4 libra nga 30 euro minimumi një libër, bën afërsisht rreth 12000 euro në vit pra baras me rrogën e tre muajve si pedagog. Pedagogu autor e krijon një libër, por nuk ka blerës për arsyen që thamë në fjalën pararendëse.

4. Botues: drejtues agjencie botuese,

ose ndryshe shtëpie botuese që boton libra, shpesh me shumicë, por ka shumë vështirësi për t'i shitur kur është fjala sidomos për libra shkencorë sepse i drejtohet në këtë rast një publiku që duhet të konsumojë shumë libra por nuk ka parë. Atëherë botuesi është i detyruar që veç librave shkencorë të botojë edhe libra mjermanë, por që ecin në një publik masiv. Është libri ta zëmë pornografik ai që mban dhe bën të mundur botimin edhe të librave shkencorë. Ose botuesi

boton shumë tituj me nivel të varfër editimi dhe botimi me qëllim që të rrisë fitimin e vet duke nxjerrë në qarkullim sa më shumë libra, pa pasur personelin dhe kompetencat profesionale për këtë. Prandaj botimet tona janë në gjendjen e mjerimit nga pikëpamja e cilësisë së redaktimit, editimit dhe cilësisë së vjedhin meqë librin e botuar me mund ia vjedhin dhe e botojnë në mënyrë ilegale, pra e kopjojnë duke shkëmbuar të drejtën e autorit. Duhet sistemi i informatizuar i librave që të realizohet kjo, por askush nuk e vendos urën në zjarr. Botuesi nuk ka me çfarë paguan autorin, që është pikërisht ai si hallka e parë dhe e fundit e procesit që varfërohet nga të ardhurat dhe duhet të jetojë me frymën e shenjtë dhe të shkruajë libra.

5. Fotokopjues: Person që vendos librat mbi xhamin e fotokopjes dhe e shtyp butonin e saj duke prodhuar faqe të fotokopjuara pa e vrarë mendjen se është duke shkelur të drejtën e autorit dhe duke rrënuar njëkohësisht edhe

botuesin, edhe librarin, edhe autorin. Por, mbi të gjitha varfëron kulturalisht edhe studentin sepse ky harxhon parë, por fletët e fotokopjuara sapo përdoren, pastaj hidhen dhe nuk vlejnjë për të bërë një bibliotekë personale. Aq më shumë edhe kultura është e varfëruar në maksimum sepse studenti bën një lexim vetëm jolinear të tekstit, ca faqe këtu dhe ca faqe atje, sepse nuk mund të lexojë një libër, i cili nuk fotokopjohet nga fillimi në fund. Edhe fotoko-

pjuesi me gjithë shërbimin e çmuar që bë, edhe pse shkatërron gjithë kuadrin ligjor të ekonomisë të kulturës, edhe pse shkatërron autorin, botuesin dhe librarin, përsëri mbetet një i varfër që paguhet keq sepse fotokopjesja shpesh edhe lokale ku është instaluar ajo nuk janë të tijat, sigurisht.

6. Politika publike për librin dhe kulturën: Këto politika që me subvencione, me zbatimin e kuadrin normativ të tregut, me ndërhyrje në treg për ta ekuilibruar atë, me studime, me investime në vepra publike, me studime, etj. duhet t'i hapin rrugë kulturës shkencore dhe përhapjes të saj, sepse pa të një popull dhe një komb varfërohet si materialisht ashtu edhe shpirtërisht dhe intelektualisht. Nuk mbrohen të drejtat e autorit. Nuk motivohen pedagogët ta shkruajnë librin shkencor, nuk ka asnjë njohje të ekonomisë të librit. As bëhet fjalë as për të investuar në biblioteka.

7. Bibliotekë: Vend ku gjithkush, sidomos një student apo shkollor, kërkues shkencor apo pedagog, mund

të shkojë dhe kundrejt abonimit apo edhe falas fare të përdorë lirshëm dhe kolektivisht librin shkencor, libra të tjerë si edhe dokumente që qarkullojnë në universin e Internetit. Mungojnë në nivel lagjeje, mungojnë në nivel qyteti, shkollë apo Universiteti. Çfarë do të thotë mungojnë që ndokush të mos nisë të bërtasë për të thënë se nuk është e vërtetë, se ato ekzistojnë. Jo të kenë një kopje libri shkencor, por aq sa ju duhet studentëve. Që të ketë libra të rinovuar dhe cilësorë. Që të jetë bibliotekë dhe qendër dokumentacioni shkencor i dixhitalizuar për të dhënë mundësi që në salla të mëdha, hapur natë e ditë, studentët dhe shkollarët të marrin bollshëm kulturë, dije, informacionin që u duhet për formimin shkollor dhe universitar. Mos shkojmë larg vetëm në vende të tjera të Mesdheut dhe do të shohim se çështja e qarkullimit të librit shkencor zgjidhet jo me tregun e lirë tejet të liberalizuar, por me politika publike, me biblioteka të të gjitha niveleve dhe shumë të pasura. Përndryshe do të kemi ndonjë botues të pasur, pastaj botues të varfër materialisht, libra mediokër, autorë të varfër dhe studentë të varfër kulturalisht që nuk mund të abuzojnë me paratë e prindërve aq të pasur sa që e kanë të pamundur të mbulojnë me financime blerjet e librave nga fëmijët e tyre. Në vend të këtij peizazhi varfanjak do të mund të kishim politika bibliotekare si pjesë e strategjive publike, ku do të kishim studentë të pasur kulturalisht, prindër pa shpenzime të kota që i varfërojnë, autorë të pasur, biblioteka të pasura me libra etj. Por, që të bëhet kjo politikë që sigurisht prek operatorë privatë në treg, shpesh varfanjakë, duhen politika publike që të mos jenë të ndikuara nga konflikti i interesit i operatorëve privatë.

Por, shikoni se edhe kur flitet për këshillat apo agjencitë zyrtare dhe publike për librin zëri, prania dhe statusi i privatëve, gjoja si operatorë, është mbisundues. Politikat publike nuk bëhen as nën presionin e privatit, dhe as duke e deleguar detyrën publike te privati. Përndryshe si varfëria kulturore ashtu edhe materiale do të vazhdojnë të mbisundojnë në një botë libri ku gjithçka është rrezuar nën peshën e ligjeve të hekurta të një ekonomie të mbetur e pakuptuar.

Për ku është nisur Shqipëria kështu?

Sot shteti shqiptar është i alarmuar dhe i tronditur nga fenomeni i radikalizmit islamik dhe rritjes së numrit të personave me prirje radikale islamike. Një situatë e tillë, ku mediat shqiptare dhe te huaja flasin për shume shqiptare e kosovarë që kanë shkuar të luftojnë në Siri në emër të Allahut, tanimë është kthyer në temë të ditës, ku imamë e hoxhallarë ditën per diell rekrutojnë besimtarë drejt vdekjes, drejt luftës së shenjtë siç mendojnë ata. Kjo situatë alarmante ka shumë vite që kultivohet në forma të ndryshme, si finan-

cime, ndërtime të shumë xhamive, rekrutime dhe shpërlarje truri duke shfrytëzuar injorancën me Kur'an në dorë. Tanimë Shqipëria ka kaluar në zbehje totale dhe mosreagim ndaj këtyre fenomeneve, ku pesë here në ditë ndezen altoparantët e xhamive duke kënduar hoxhallarët dhe ndotjet akustike janë bërë një natyrshmëri e jetës së përditshme. Nuk ka individë a grupe shoqërore që të kundërshtojë këto rryma, as nisma politike jo që jo, pasi radikalët islamikë tanimë janë aq të organizuar sa kanë pushtet e force

të hakmerren sipas formës së tyre. Kushdo guxon të ngrejë zërin për një Shqipëri perendimore, me profil demokristian, ndeshet në zemërimin e rakilizmit islamik. I tillë është Tonin Mark Pecaj. Ky shqiptar punoi shumë, derë në derë, për një kulturë europiane, demokristiane, deri sa acaroi fort radikalët islamikë, të cilët e kërcënuan me metodat dhe presionet e tyre duke e detyruar të largohet larg atdheut pa grua dhe familje. Më vonë, duke e kuptuar se nuk ka rrugë tjetër, detyrohet ti marrë me vete edhe ata. Tonin Pecaj

ka punuar shumë për një Shqipëri demokristiane, me financime dhe njerëzit e tij që i shkonin pas, pasi rrjedh nga një familje me taban katolik, ku edhe gjyshi i tij ishte i dënuar politikisht në kohën e diktaturës komuniste. Tonin Pecaj do mbetet në kujtesë për punën e madhe në këtë drejtim, sidomos në zgjedhjet parlamentare të vitit 2009, ku ishte në krah të kandidatit për deputet të partisë demokristiane në Malësinë e Madhe Aleksandër Kekaj. Radikalët myslimanë duke qënë të forte, punonin kunder demokristianëve, madje edhe me deklarata duke përkrahur kandidatët e fesë së tyre. Kandidati demokristian për deputet



Aleksander Kekaj, u vra nga një shpërthim me tritol në makinën e tij, në kulmin e fushatës elektorale. As sot nuk ka autor kjo vrasje mafioze. Kështu miku i tij sot, Tonin Pecaj, megjithëse ka lënë babain në krevat, të paralizuar, që pret nga dita në ditë djalin dhe nipat e tij, ku nga sëmundja nuk dihet sa do jetojë, të paktën mëndon të jetojë jetën dhe të mos vritet si ish kandidati për deputet Aleksander Kekaj. Në fund të fundit, duam të pyesim politikbërësit, për ku është nisur Shqipëria kështu, drejt Europës apo Arabisë?

Redaksia

Kthetrat e mazokizmit si idhujtari partitokratike ndryshe Njëra nga sfidat më serioze të një Rilindjeje të vërtetë

Reagimi sistematik grek, në dogana, në dëm të një komunikimi normal për mijëra e mijëra qytetarë shqiptarë: Fëmijë, gra, të moshuar, emigrantë me probleme dhe halle nga më alarmantet ka qenë gjithnjë një reagim aspak burokratik, teknik apo defektesh nga më të ndryshme, por ka qenë dhe do të jetë një strategji e vet shtetit grek për të qenë kurdoherë në raporte superioriteti me shtetin shqiptar, në kuptimin e asaj filozofie skllavëruese, që mjerisht prej kaq vitesh ushqehet nga sjellja mazokiste e vet klasës sonë politike. E theksoj këtë fakt, aspak për herë të parë, sepse cilado forcë politike, që ka ardhur në pushtet, mjerisht, ka heshitur apo thjesht është shtirur sikur po reagon ndaj akteve antishqiptare të grekëve, lexo të qeverisë së tyre, në kurriz të dinjitetit të shqiptarëve.

Kjo frymë ka berë që, në emër të aritjes së kësaj apo asaj mbështetje nga pala greke, ndryshe të këtij apo atij objektiv në proceset e integritimit, shqiptarët, lexo klasa jonë politike, ka pranuar në heshtje denigrimin e personalitetit të shqiptarit deri në diskriminim: Vrasjet, përcudnimet me emrat, tash së fundi edhe me toponimet, janë faktikisht provat më ekselente të presionit grek për ta ruajtur si rezervat të interesave të veta Shqipërinë duke njohur etjen për të mbajtur me çdo kusht pushtetin, pra etjen partitokratike tek cilido ekzekutiv yni në këto 22 vjet. Reagimi i Kryeministrit të ri, në pritje, Z. Rama apo edhe i ministrit të Jashtëm, z. Bushati ndaj brutalitetit doganor, ditët e fundit, kam bindjen se është prologu i asaj Rilindjeje që pritet edhe në aspektin diplomatik filluar me fqinjën grek dhe cilindo partner, larg frymës së kultit të cilësdo fuqie politike, si një idhujtari skllavëruese,

Modeli Rama, në këtë vështrim, shpresoj të shpalsë vetveten me dinjitet duke na dhuruar edhe në këtë aspekt një risi diplomatike.

E them këtë, sepse megjithëse investimet greke në Shqipëri

antifashisti të njohur çam, gjak i një kombi që ka dhënë gjak më shumë se asnjë komb, për frymë. për lirinë kundër nazifashizmit, të kërkoj ndihmën e ambasadorit amerikan Arvizu që të

dinjitet, nga qeveria Rama, në thelbin e tyre fizofik, politik, diplomatik dhe aspak si hipokrizi civile nën ethet e mazokizmit që e ka cënuar keqas dinjitetin e marrëdhënieve mes dy shteteve

metrash masakruar në kufirin me Greqinë, kur qarjet e foshnjeve, britmat e te pamundurëve nga mosha, nga shëndeti, urgjencat e hallexhinjeve të pafund në pritje skëterrosëse në automjetet e

tyre shoqëroreshin me cinizmin brutal të autoriteteve greke, edhe pse ekraneve tona dhe të botës, qeveritaret tanë prej 22 vitesh byrleken për marrëdhënie miqësore emblematike, Të të nderojë tjetri, duhet më parë të nderosh vetveten-ky është kodi diplomatik i komunikimit në Epokën e Dialogut dhe të Integritimit si vlerë demokratike:

Të dua ty, sepse dua veten, respektoj lirinë tënde, sepse e urrej skllavërinë ndaj të tjerëve, po aq sa ndaj vetes, aq më shumë si sjellje e më të fortit ndaj më të dobët.

”Çështja e integritit evropian nuk mund të trajtohet si marrëdhënie mes gjykatës, Evropës dhe fajtorëve, vendeve të Lindjes, që i kishin ikur si djem plangprishës kontinentit mëmë, - thekson te Vaclav Havel -, përkundrazi marrëdhëniet mes palëve

duhen parë vetëm si barazi dhe përgjegjësi e përbashkët e tyre, si rol barazisht aktiv i të dy palëve.. Mënyra e të parit të gjërave për t’iu bashkangjitur më të fortit të momentit, ndryshe “për t’i zhvatur” diçka në formën e një fëmije që pret të vlerësohet, se sillet mirë dhe me edukatë, është pikërisht burimi i prapambetjes sonë në Integritimin evropian”. Vetëm tek kjo filozofi, si filozofia e një Rilindjeje të vërtetë, tek e cila sot besojnë shqiptarët, pa le ç’përrallisnin oborrarët e skemave të modelit të shkundur nga pushteti me votën plebeshitare të qershorit 2013-të, personalisht e shoh ardhmërinë tonë normale, edhe në aspektin problematik, me sht

Kadri Ujkaj



gjatë këtyre dekadave kanë rrokur ndër vite edhe shifrën mbi 60% krahasuar me partnerë të tjerë, ndërkombëtarë, trajtimi i shqiptarëve ka qenë përherë mizerabël: Shqiptari nuk guxon të flasë publikisht, në gjuhën e vet, me shqiptarin, shqiptari që derdh aq shumë djersë dinjiteti në ndërtimin e Greqisë së Re nuk guxon të artikulojë as emrin e vet, emrin që i vuri nëna apo babai kur erdhi në jetë, shqiptari (këtu kam parasysh çamët) që po investon djersën dhe mundin e tij në Greqinë e ditëve tona nuk guxon të kujtojë as varret e të parëve, nuk guxon të shkojë as në trojet e veta, nga lloj-lloj cenesh të prodhuara nga vetë strukturat qeverisëse greke.

A ka më kulminacion poshtëruar se sa momenti kur një shqiptar nga Filati, djali i një

shkojë në Filat(Çamëri).?!? Dhe brenda se keqes nga shteti grek, personalisht, shoh dhe besoj të mos e shoh më, ka qenë edhe sjellja poshtëruar e një mazhorance në emër të të ashtuquajturës së një diplomacie të matur, faktikisht përpjekjes në çdo rrethanë për të jetëzgjatur kulltukun qeverisëse, klientelist dhe aspak shëndetin e demokracisë shqiptare. Çdo sjellje apo qëndrim politikani apo qeverie që robëron popullin e vet nuk është tjetër vetëm sjellje prej pushtuesi ndaj kombit të saj, ndaj popullit që e ka votuar, ndryshe një tallje cinike dhe nëpërkëmbje e vullnetit të Sovranit që i besoi votën e tij. Kjo përvojë mjerane, kjo traditë e ligë, e pabesë ndaj popullit të vet, kam bindje që do të jetë hipoteza më serioze për ndërtimin e marrëdhënieve me

fqinje,, Interesi kombëtar vazhdon të jetë pika më e dobët e vet Bashkimit Evropian, kësaj fuqie të madhe progresuese, krahas SHBA, merret me mend se çfarë statusi karikaturë, skllavërues fiton ardhmëria e një vendi të vogël si yni, nëqoftëse qeveritarët tanë, politikanët tanë, klasa jonë politike në tërësi dhe veçanarisht mazhoranca qeverisëse harron këtë Thembër Akili brenda vetvetes duke injoruar thelbin e misionit të saj në një shoqëri të hapur: Përmirësimi maksimal i jetës ekonomike, kulturore, shpirtërore e qytetareve të saj, te cilët vendin e tyre kanë të drejtë ta shohin jo në rugën e një superkolonie, në shinat e një rrugëtimi skllavërues është detyra nr.1 e shtetit tonë ligjor. Kujtoni kalvaret prej disa kilo-

Njihu me Sekretin e Madh të jetës tënde



Dezdemonia Marku

...Kur shohim përreth nesh, madje edhe trupin tonë, ajo që shohim është maja e ajsbergut.

Dr. John Hegelin

Mendo për këtë një çast. Shikoje dorën tënde. Ajo duket e fortë, por në të vërtetë nuk është e tillë. Nëse do ta vije nën një mikroskop të përshtatshëm, do të shihje një mase energjie që dridhet.

Bob Proctor

Gjithçka është bërë nga e njëjta substancë, qoftë dora jote, oqeani apo edhe një yll.

John Assaraf

Gjithçka është energji dhe më lejo të të ndihmoj ta kuptosh paksa këtë. Kemi Universin, galaktikën tonë, planetin tonë dhe pastaj janë individët; dhe brenda këtij grupi janë sistemet e organeve, qelizat, molekulat dhe pastaj atomet. Dhe më pas është energjia. Pra, nivelet për të cilat mund të mendosh janë të shumta, por në Universin gjithçka është energji.

Dr. Ben Johnson

Kur zbulova Sekretin, doja të dija opinionet e shkencës dhe të fizikës për sa i përket kësaj njohjeje. Ajo çka zbulova ishte absolutisht mahnitëse. Një prej gjërave më entuziazmuete të të jetuarit në këtë kohë është që zbulimet e fizikës së kuantave dhe shkencës së re janë në harmoni të plotë me mësimet e Sekretit dhe me ato që mësuesit e mëdhenj kanë ditur gjatë gjithë rrjedhës së historisë.

Në shkollë nuk kam studiuar asnjëherë shkencë apo fizikë, por prapë prapë, kur lexoja libra të ndërlikuar mbi fizikën e kuantave, i kuptoja në mënyrë të përsosur, sepse doja ti kuptoja. Studiimi i fizikës së Kuantave më ka ndihmuar ta kuptoj më në thellësi Sekretin, në një këndvështrim energjitik. Bindja e shumë njerëzve përforcohet kur ata shohin ndërsjellshtësinë perfekte mes njohjes së Sekretit dhe teoritëve të shkencës së re.

Më lejo të shpjegoj se si ti je kulla më e fuqishme e transmetimit në Universin. Thënë me fjalë të thjeshta, gjithë energjia dridhet në një frekuencë. Duke qenë energji, edhe ti dridhesh në një frekuencë që përcaktohet nga ajo çka ti mendon dhe

ndien. Të gjitha gjërat që do, janë të bëra nga energjia. Edhe ato dridhen. Gjithçka është energji.

Këtu hyn faktori "suprizë". Kur mendon për atë që do dhe e emeton këtë frekuencë, bën që energjia e asaj çfarë dëshiron të dridhet në atë frekuencë dhe e tërheq drejt Teje! Kur përqendrosh në atë që dëshiron, ndryshon dridhjen e atomeve të asaj gjëje dhe bën të dridhet drejt Teje. Ti je kulla më e fuqishme e transmetimit në Universin, sepse të është dhënë fuqia për ta përqendruar energjinë tënde nëpërmjet mendimeve të tua dhe të ndryshosh dridhjen e gjërave në të cilat je përqendruar, që më pas i tërheq magnetikisht drejt vetes.

Kur i mendon dhe i ndien gjërat e mira që dëshiron, je futur menjëherë në atë frekuencë, e cila më pas bën që të dridhet drejt teje energjia e tyre dhe ato shfaqen në jetën tënde. Ligji i tërheqjes thotë se të ngjashmit të tërheqin të ngjashmit. Ti je një magnet energjie, ndaj dhe energjizohet elektriciteti gjithçka drejt teje, e energjizohet elektriciteti veten drejt gjërave që dëshiron. Qeniet njerëzore e administrojnë energjinë e tyre magnetizuese, sepse askush jashtë tyre nuk mund të mendojë ose të ndiejë për ta; dhe janë mendimet dhe ndjenjat ato që krijojnë frekuencat tona.

Rhonda Byrne

Nga ç'është këndvështrimi që ta shohësh, rezultati është gjithmonë i njëjti. Në jemi Një. Jemi të gjithë të lidhur dhe jemi pjesë e Fushës Energjitike Unike, e Mendjes Supreme Unike, e Vetëdijjes Unike ose e Burimit Krijues Unik. Quaja si të duash, por jemi të gjithë Një.

Rhonda Byrne

Nëse tani mendon për ligjin e tërheqjes, i vetëdijshëm që të gjithë ne jemi Një, do të shohësh performancën absolute.

Rhonda Byrne

Do të kuptosh pse mendimet e tua negative për dikë tjetër rikthehen që të dëmtojnë vetëm Ty. Jemi Një! Nuk mund të pësosh dëme nëse nuk i thërret ato duke emetuar mendime dhe ndjenja negative. Të është dhënë vullnet i lirë që të zgjedhësh, por kur ushqen mendime negative dhe ke ndjenja negative, e ndan veten nga e Mira Unike dhe Absolute. Mendo për emocionet negative që ekzistojnë dhe do të zbulosh se secili prej tyre bazohet te frika. Këto emocione lindin nga mendime ndarjeje dhe nga të shikuarit e vetes si të ndarë nga të tjerët.

Rhonda Byrne

Konkurrenca është një shembull i ndarjes. Së pari, mendimet e tua mbi konkurrencën vijnë nga një mentalitet mungese, sepse është sikur po thua që ka rezerva të kufizuara. Po thua që nuk ka mjaftueshmëri për të gjithë, ndaj duhet të bëjmë konkurrencë e të luftojmë për të marrë gjëra. Kur bën konkurrencë, nuk mund të fitosh kurrë, edhe nëse mendon se ke dale i fituar. Në bazë të ligjit të tërheqjes, kur je në konkurrencë tërheq shumë njerëz e rrethana që hyjnë në konkurrencë me Ty në çdo aspekt të jetës tënde dhe në fund humbet. Jemi të gjithë Një, prandaj kur hyn në konkurrencë, hyn me veten Tënde. Duhet ta heqësh konkurrencën nga mendja dhe ta bësh këtë të fundit krijuese. Përqendro tek ëndrrat e tua, të vizionet e tua dhe hiqe konkurrencën nga jeta jote.

Rhonda Byrne

Universi është rezerva Universale dhe furnizuesi i gjithçkaje. Çdo gjë që vjen nga Universi dhe transportohet tek ti nga ligji i tërheqjes nëpërmjet njerëzve, rrethanave dhe ngjarjeve. Konsideroje ligjin e tërheqjes si ligjin e furnizimeve. Është ligji që të lejon të tërheqësh nga rezervat e pafundme. Kur emeton frekuencën e përkryer të asaj që dëshiron, do të tërheqësh njerëzit, rrethanat dhe ngjarjet e përkryera!

Rhonda Byrne

Nuk janë njerëzit ata që të japin gjërat që dëshiron. Nëse i përmbaheh kësaj bindjeje të rreme, do të përjetosh mungesa, sepse e sheh botën e jashtme dhe njerëzit si rezerva. Rezervat e vërteta janë fusha e padukshme, nëse ti e quan atë Universin, Mendja Supreme, Zoti, Inteligjenca Infinitive apo çfarëdo tjetër. Sa herë që merr diçka, kujto që e ke tërhequr nëpërmjet ligjit të tërheqjes, duke qenë në frekuencë dhe në harmoni me Rezervën Universale. Inteligjenca Universale, që përhap gjithçka, ka vënë në lëvizje njerëz, rrethana dhe ngjarje, me qëllim që të ta japë ty atë gjë, sepse kështu funksionon ligji.

Rhonda Byrne

Shumë njerëz ndihen sikur janë viktimë në jetë dhe shpesh ua hedhin fajin ngjarjeve të kaluara, ndoshta ngaqë janë rritur me një prind abuziv apo në një familje jofunksionale, prandaj papritmas na rezulton që ti nuk je dhe ajo nuk.

Prindërit e mi ishin të alkoolizuar. Im atë abuzonte me mua. Ime më u divorcua me të kur unë isha gjashtë vjeç... Dua të them, kjo është pothuajse historia e kujtdo në një formë a tjetër. Pyetja shtrrohet: çfarë do të bëj tani? Çfarë zgjedh tani? Sepse duhet të përqendrosh te kjo ose tek ajo që do. Dhe kur njerëzit fillojnë të përqendrohen tek ajo që duan, ajo që duan nuk ikën, ndërkohë që pjesa që duan zgjerohet dhe tjetra zhduket.

Jack Canfield

"Një person që e përqendron mendjen në anën e errët të jetës, që i përjeton herë pas here fatkeqësitë dhe zhgënjimet e së shkuarës, praktikisht lutet për fatkeqësi dhe zhgënjime të ngjashme në të ardhmen. Nëse në të ardhmen tënde nuk do të shohësh gjë tjetër veçse fat të keq, ti po lutesh për një fat të tillë dhe me siguri një fat të tillë do të kesh."

Prentice Mulford

Nëse e sheh jetën tënde në retrospektivë dhe përqendrosh të vështirësitë e së shkuarës, je duke tërhequr më shumë rrethana të vështira drejt Teje. Çlirohu prej saj, pavarësisht se çfarë është. Bëje për veten. Nëse vazhdon t'i mbash mëri ose të fajësosh dikë për diçka që të shkuarën, je duke i bërë dëm vetëm Vetes. Je i vetmi që mund të krijosh jetën që meriton. Kur të përqendrosh qëllimisht në atë që do, kur të fillosh të emetosh ndjesi të mira, ligji i tërheqjes do të të përgjigjet. Të duhet vetëm të fillosh; dhe duke e bërë këtë, do t'i hapësh rrugë të lirë magjisë.

Rhonda Byrne

Ti je projektuesi i fatit tënd. Ti je autori. Je ti ai që e shkruan historinë. Stilolapsi është në dorën tënde dhe rezultati është ajoçka zgjedh ti.

Lisa Nichols

E bukura e ligjit të tërheqjes është se mund të fillosh aty ku je, mund të fillosh të formulosh "mendime të vërteta" dhe të krijosh brenda vetes një ton harmonie dhe lumturie. Atëherë ligji do të fillojë t'i përgjigjet gjithë kësaj.

Michael Bernard Beckwith

Ndërkaq ti fillon të kesh bindje të ndryshme, si për shembull: "Në Universin ka më se mjaftueshmëri." Ose: "Nuk po plakem, por rinohem." Mund ta krijosh si ta duam, duke përdorur ligjin e tërheqjes.

Dr. Joe Vitale

Dhe mund të çlirohesh nga modelet e trashëguara, kodet kulturore apo bindjet shoqërore dhe të provosh një herë e mirë se fuqia që gjendet brenda teje është më e madhe se ajo që gjendet brenda botës.

Michael Bernard Beckwith

Ti mund të mendosh: "E po, është shumë bukur, por nuk e bëj dot." Ose: "Ajo nuk do të më lërë ta bëj!" "Ai nuk do të më lërë kurrë ta bëj." "Nuk jam aq i fortë për ta bërë." "Nuk jam aq i pasur për ta bërë." "Nuk jam, nuk jam, nuk jam..." Çdo "nuk jam" është një krijim!

Dr. Fred Alan Wolf

Është ide e mirë të bëhesh i vetëdijshëm, kur thua "nuk jam" dhe të mendosh se çfarë krijon kur e thua. Ky mësim i fuqishëm i dr. Wolf-it është dokumentuar edhe nga të gjithë mësuesit e mëdhenj, të cilët, ashtu si ai, e dinin fuqinë e fjalëve unë jam. Kur thua "unë jam", fjalët që pasojnë tërheqin krijimin me një forcë të madhe, sepse ti po pohon që ky është fakti i kryer. Po e miraton me siguri. Prandaj, menjëherë pasi thua: "Unë jam i lodhur, jam trrokë, jam i sëmurë, jam vonë, jam mbipeshë, jam plak," Xhindi thotë: "Dëshirat e tua janë urdhra për mua".

Rhonda Byrne

Duke e ditur këtë, a nuk do të ishte ide e mirë të filloje t'i përdorje në favorin tënd dy fjalët më të fuqishme: UNË JAM? Si thua? "UNË JAM duke marrë çdo gjë të mirë. UNË JAM i lumtur. UNË JAM i pasur. UNË JAM dashuria. UNË JAM gjithmonë në kohë. UNË JAM rinia e përjetshme. UNË JAM plot energji çdo ditë."

Rhonda Byrne

Pohimi është ky: "UNË JAM i plotë, i përkryer, i fortë, i fuqishëm, i dashur, i harmonishëm dhe i lumtur."

Rhonda Byrne

Nëse kjo të jep përshtypjen se duhet të punosh shumë për ta nxjerrë atë nga e padukshmja je të dukshmen, provo këtë mënyrë të shkurtër: shikoje atë që dëshiron si të ishte fakt absolute. Kjo do të bëjë që ajo që ti dëshiron të realizohet me shpejtësinë e dritës. Në çastin që kërkon, objekti i dëshirave të tua është fakt në fushën shpirtërore Universale dhe ajo fushë është gjithçka që ekziston. Kur percepton diçka në mendjen tënde, dije që bëhet fjalë për një fakt dhe që do të realizohet pa dyshim.

Rhonda Byrne

"Nuk ka limite se çfarë mund të bëjë ky ligj për ty; guxo të besosh në idealin tënd; mendoje idealin tënd si një fakt tashmë të kryer."

Charles Haanel

"Si të mendosh që mund ta bësh, ashtu edhe që s'mundesh, në të dyja rastet ke të drejtë."

Henry Ford (1863 – 1947)

Nuk ka asnjë dërrasë të zezë në qiell, në të cilën Zoti të ketë shkruar qëllimin dhe misionin tënd në jetë. Nuk ka asnjë dërrasë të zezë në qiell, që të thotë: "Neale Donald Walsch. Një djalë simpatik, i cili ka jetuar në pjesën e parë të shekullit të njëzetë, i cili..." Pastaj një hapësirë

bosh. Gjithçka që më duhet për të kuptuar se çfarë bëj këtu, pse jam këtu, është ta gjej atë dërrasë të zezë e të mbulojë e të zbuloj çfarë ka Zoti në mendje për mua. Por dërrasa e zezë nuk ekziston.

Pra, qëllimin tënd e përcakton ti vetë. Misioni yt është misioni që i jep ti vetes. Jeta jote do të jetë si ta krijosh ti dhe askush nuk do ta gjykojë as tani dhe as kurrë.

Je i detyruar ta mbushësh dërrasën e zezë të jetës tënde me gjithçka që dëshiron. Nëse e ke mbushur me plaçka të së shkuarës, fshije. Eliminon gjithçka nga e shkuara që nuk të shërben, ji mirënjohës që të ka sjellë në këtë vend tani dhe në një fillim të ri. Ke një dërrasë të pastër dhe mund t'ia nisësh nga e para – këtu, në këtë çast. Gjej qëllimin tënd dhe jetoje!

Neale Donald Walsch

Sekretit është brenda teje. Sa më shumë ta përdorësh fuqinë që gjendet brenda teje, aq më shumë do ta tërheqësh. Do të arrish në një pikë ku nuk do të kesh më nevojë të praktikosh, sepse ti vetë do të jesh fuqia, perfekcioni, mençuria, inteligjenca, dashuria dhe qëllimi

Rhonda Byrne

Toka rrotullohet rreth orbitës së saj për Ty. Oqeanet ngrihen dhe ulen për Ty. Zogjtë këndojnë për Ty. Dielli lind dhe perëndon për Ty. Yjet dalin për Ty. Gjithçka është për Ty, çdo që e bukur që sheh, çdo përvojë e mrekullueshme që përjeton. Hidh një sy përreth. Asgjë nga ato që të rrethojnë, nuk mund të ekzistojnë pa Ty. Pavarësisht se çfarë ke menduar se ke qenë, tani e di të Vërtetën se kush je Realisht. Je padroni i Universit. Je trashigimtari i mbretërisë. Je perfeksioni i Jetës. Dhe tani e di Sekretin

Gëzimi qoftë me ty.

Rhonda Byrne

"Sekreti është përgjigja mbi gjithçka që ka qenë, gjithçka që është dhe gjithçka që do të jetë."

Ralph Emerson

Duhet ta gjesësh dërrasën e zezë të jetës tënde me të gjitha gjërat që të dëshiron.

Rhonda Byrne

Gjëja e vetme që duhet të bësh është të ndihesh mirë tani.

Rhonda Byrne

Sa më shumë të përdorësh fuqinë që gjendet brenda teje, aq më shumë do ta tërheqësh atë.

Rhonda Byrne

Koha për të pranuar madhësitë tënde është tani.

Rhonda Byrne

Jemi në mes të një epoke të lavdishme. Nëse i mënjanojmë mendimet kufizuese, do të përjetojmë madhësitë e vërtetë të njerëzimit në çdo fushë krijimi.

Rhonda Byrne

Bëj çfarë të pëlqen. Nëse nuk e di çfarë të sjell gëzim, bëj pyetjen: "Çfarë më sjell gëzim?" Dhe ndërsa i përkushtohesh gëzimit tënd, do të tërheqësh një ortek gjërash të gëzueshme për faktin e njëjshë që ti rrezaton gëzim.

Rhonda Byrne

Tani që ke mësuar Sekretin, varet nga ti se çfarë do të bësh me të. Çfarëdo të zgjedhësh, është e drejtë. Fuqia është e gjitha e jotja.

Rhonda Byrne

TRITOL DHE PLUMBA MBI BIZNESMENËT

Biznesmeni i njohur shkodarë në fushën e ndërtimit Arben Uk Hyseni është vënë në shënjestër të plumbave rreth orës 19:00 të datës 26 janar 2014 në lagjen Kiras, ku vetëm falë fatit makina me të cilën udhëtonte ka shpëtuar duke u larguar me shpejtësi dhe në këtë rast edhe duke terrorizuar këmbësorët e rastësishëm. Në të njëjtën datë, por një muaj më vonë, më 26 shkurt 2014 në kryeqytet, në Tiranë, në mëngjes

teksa biznesmeni tjetër i ndërtimit Armando Ceka po hapte lokalin e tij së bashku me Julian Çelen dhe Artur Sharrën, u gjenden përballë shpërthimit me tritol, ku u plagosën që të tre dhe u dërguan në spitalin e Tiranës në gjendje të rëndë. Të dy rastet lidhen me borxhet që biznesmenët kanë. Rasti i Tiranës ka qënë mjaft i ndërlikuar, pasi u lakua në media se Armando Ceka është nipi i politikantit të njohur shqiptar Ne-

ritan Ceka dhe mund të jetë edhe i përfshirë në afëra, ndërsa rasti i biznesmenit Arben Hyseni është i qartë. Ai kishte biznes të suksesshëm prej më shumë se dhjetë vitesh në fushën e ndërtimit, por që nga viti 2009 kur edhe në Shqipëri u ndie kriza ekonomike, sidomos në ndërtim ku edhe shteti u mbeti shumë borxhe bizneseve, ai ishte detyruar të marrë borxhe me fajde në kohën që bankat i kishin ngurtësuar

kreditë. Kështu, në pamundësi të rikthejë borxhet, detyrohet të myllë biznesin, duke u kërcënuar shumë herë më jetën e tij dhe të familjes deri në ditën që huadhënesit vëndosën ta qëllonjë me plumba. Pasi arrin të shpëtojë, kjo familje detyrohet të largohet nga Shqipëria, ndërsa biznesmeni Armando Ceka ende vazhdon të jetë në spitalin e Tiranës dhe sipas burimeve spitalore ka mbetur sakat në këmbën e djathtë. Trajtuam dy raste të të njëjtës datë të dy muajve të fundit, raste që nuk shënuan të vdekur, për ti bërë thirrje kësaj politike të çmëndur, ta largoi sadopak vëmëndjen nga korrupsioni galopant dhe krimi me prapaskenë politikën dhe të merret edhe me

qytetarët e pafajshëm që po bëhen viktimë të njëjtit kohe pa ligje dhe sistëm demokratik. Vetëm këta dy muajt e fundit, sidomos ndaj biznesmenëve që janë mbytur ne borxhe jo për faj të tyre por të politikave të këqija qeveritare, atentatet dhe vrasjet janë shtuar shumë. Sipas deputetit demokrat Arben Ristani, në janar të 2014 janë 17 vrasje, ndërsa në shkurt 11 vrasje, pa futur këtu rastet e tjera kur viktimat u kanë shpëtuar atentateve, normalisht për tu përballë sërish me plumbat ose tritolin, duke e kthyer Shqipërinë në një Siri të dytë.

Redaksia

Zbulohet një libër në gjuhën shqipe, më i vjetër se "Meshari"

Behar Gjoka

Janë përsëri ata, austriakët, të dashuruarit e përgjeshëm me shqipen, që këtë radhë na befasojnë me një tjetër zbulim. Bëhet fjalë për një dokument që mund të hedhë dritë për shkrimin më të hershëm të gjuhës shqipe. Profesorët Stefan Schumacher dhe Joachim Matzinger nga Akademia e Shkencave Austriake kanë arritur të zbulojnë një dokument që mendohet t'i përkasë shekullit të XIV, ku shkruhet një shqipe me germa latine.

Studimi ka si qëllim zbulimin e ndikimit të gjuhës shqipe në të gjithë gjuhët e rajonit, por edhe në gjuhët e vdekura. Dy profesorët në studimin e tyre kanë arritur në përfundimin se një pjesë e gjuhëve si latinisht, gjermanisht dhe thuajse pjesa më e madhe e gjuhëve të Ballkanit, kanë elementë të rëndësishëm të gjuhës shqipe. Fakti se një pjesë e foljeve kryesore të shqipes gjenden në këto gjuhë, e vërteton më së miri këtë gjë.

Dy profesorët kanë paraqitur fletën e një libri të Biblës që dokumenton gjuhën shqipe të shkruar në fillim të shekullit të XVI. Nëse do të vërtetohet origjinaliteti i këtij dokumenti, atëherë kemi të bëjmë me një libër më të hershëm se "Meshari" i cili daton në mes të shekullit të XVI. Zbulimi Nuk dihet nëse kemi të bëjmë me një zbulim të mirëfillt shkencor apo jo. Dokumenti që publikohet në web-in zyrtar të Akademisë së Shkencave të Austrisë pretendon se bëhet fjalë për shqipe të shkruar rreth shekullit XIV.

Përcaktimi më i saktë i datës do të shërbente për të vërtetuar nëse "Meshari" i Gjon Buzukut është i pari libër i shkruar në shqip apo më në fund gjuhësia ka arritur të gjejë dokumente të tjerë që e vërtetojnë këtë gjë. Në foto jepet fleta e një libri fetar, i shkruar në italisht dhe në shqip. "Scala I. Ligierata VI. Si e krijoi 3ot\$ne Adamne et Evene. Të parët tanë print", që kuptohet

"Ligjërta e VI. Si e krijoi Zoti Adamin dhe Evën, prindërit tanë të parë".

Në gjurmët e Joklit Dy profesorët austriakë kanë përdorur materialet dhe dokumentet e themeluesit të shkencës së Al-

gjuhëtarët pranojnë se shqipja duhet të jetë shkruar shumë kohë më parë, dokumenti i parë që e dëshmon këtë është "Formula e pagëzimit", e shkruar nga kryepeshkopi i Durrësit, Pal Ëngjelli, gjatë një vizite në dioqezën e

pari libër në gjuhën shqipe. "Meshari" i përket vitit 1555. Por të gjithë studiuesit janë të një mendimi kur flasin për dokumentet më të hershme.

Këtë e dëshmon dhe Arqipeshkvi francez i Tivarit me

një qarkore latinisht, ku lejon që në kohë lufte fëmijët të pagëzoheshin në shqip. Formula është: «Un të pagëzoni prëmen» Atit e t'birit e t'shpirtit shenjt» shqip. Fjalori i Arnold Fon Harfit (1497) Janë 26 fjalë shqip, 8 shprehje



banologjisë, Norber Jokl. Jokl ka lindur në 25 shkurt 1887 dhe është vranë nga nazistët në maj 1942. Edhe pse me një formim juridik, Jokl iu përkushtua gjuhësisë dhe kryesisht studioi gjuhët indo-evropiane, gjuhët sllave dhe gjuhët romane. Një vëmendje të veçantë i ka kushtuar gjuhës shqipe. Në moshën 30-vjeçare mësoi gjuhën shqipe. Është autor i librave "Studime mbi etimologjinë dhe fjalëformimin e shqipes" dhe "Kërkime gjuhësore - kulturore historike nga fusha e shqipes".

Dokumentet e hershme të shqipes Deri më sot tre cilësohen si dokumentet më të hershme të shqipes. Edhe pse gjithë

Matit në 8 nëntor 1462. Dokumenti i dytë është fjalori i Von Harfit, i vitit 1497.

Dokumentet që përmban një numër fjalësh dhe shprehjesh që i duheshin udhëtarit gjerman gjatë kalimit të tij në Shqipëri në Durrës dhe në Ulqin. Të së njëjtës rëndësi, gjuhëtarët rendisin dhe "Perikopeja e Ungjillit të Pashkës". Një dokument i shkruar në greqisht, që mendohet se i përket shekullit XV ose fillimit të shekullit XVI. Ky dokument përbëhet nga 2 pjesë të vogla Bible në gjuhën shqipe, që u gjetën në një dorëshkrim greqisht të shekullit XIV. Por si dokumenti më i rëndësishëm deri më sot mbahet "Meshari" i Gjon Buzukut, i

emrin Brokard, që ka udhëtuar në Shqipëri. Në një relacion latinisht të vitit 1332, ai shkruan: "Sado që shqiptarët kanë një gjuhë fare të ndryshme nga gjuha latine, prapë ata kanë në përdorim edhe në tërë librat e tyre shkronjën latine". Një gjë mund të thuhet me siguri: Nëse dokumentet shqipe ekzistojnë, zbulimin e tyre mbetet ta presim gjithmonë nga të huajt. Formula e Pagëzimit 1462 Dokumenti i parë i vërtetuar i shqipes i përket datës 8 nëntor 1462.

Është shkruar nga Kryepeshkopi i Durrësit, Pal Ëngjelli, gjatë një vizite në dioqezën e Matit. Duke parë mangësitë në ushtrimin e fesë, Pal Ëngjelli lëshon

dhe numrat nga 1 deri 10 dhe 100 e 1000. Fjalori modest i udhëtarit Arnold Fon Harfit ka një rëndësi të madhe për gjuhën shqipe, duke qenë është i pari dokument i shprehjeve dhe numrave.

Fjalori është zbuluar në vitin 1860, Fon Harvi udhëtoi në Durrës dhe në Ulqin. "Meshari" i Buzukut 1555 Është i pari libër i gjuhës shqipe që është gjendur deri më sot. "Meshari" përbëhet nga 110 fletë ose 220 faqe. Originali i librit që ka arritur të gjendet përbëhet nga 94 fletë. Libri është kishtar dhe është shkruar në gjuhën latine, ka 154 000 fjalë. Është në dialekt verior dhe originali gjendet në Arkivat e Vatikanit.

DITA E MBRAME E RAMIZ ALISE...

...Kur ra zilja e telefonit ,Sali Berisha u zgjua menjehere dhe neper terr hapi celularin...zeri i Guro Zenelit sekretarit te Ramiz Alise e zgjoi menjehere...

"Shoku Ramiz eshte ne momentet e fundit te jetes se tij!"-mezi degjoi zerin e Gurit mbytur nga ngasherimi..."Eja se te ka kerkuar!"...

Berisha pa oren,ishte 4:04 minuta,data 7 tetor 2011...Ora dallohej qarte ne ekranin e iPad 4 ate qe e kishte fiksim dhe qe e mbante gjithmone te koka e shtratit...Fillimisht Berisha u perpoq te merrte mend se cfare po ndodhte?!Ishte ora kater e mengjesit dhe zeri i Guri Zenelit,sekretarit te shokut Ramiz menjehere i kujtoi nje mengjes Dhjetori 1990 kur po ashtu kaq heret ne mengjes e pati thirre qe te shkonte ne Qytetin Studenti.Sikur te mos ishte celulari dhe ndrizimi fosforeshent I ores ne iPad 4 Sali Berisha do kishte kujtuar se kishte pare nje enderr .Por timbri I zerit ne telefon ishte real,bile Guri ende po fliste,se cpo thoshte!?!...Berisha u kthye menjehere ne realitet,u shkund nga perhumbja...

"Erdha menjehere!"-I tha Gurit...u ngrit dhe u vesh me nxitim...

"Per ne spital!"-u tha Sali Berisha shoferit dhe rojave qe nxituan me vrap ta ndiqnin...

Duke ngjitur shkallet nga dy e tre njeheresh Berisha hyri me vrap ne dhomen ku dergjej Ramiz Alia... Shkoi menjehere te shtrati edhe ja shterngoi doren.Ne te djathte te shtratit pa Sabit Brokajn I cili e shikoi venger... ne fakt kurre nuk e kishin hon-epsu mjeri-tjetrit!Pastaj u kthye dhe shikoi rreth e rrotul...ne dhome gjendeshin te gjithë... Gramoz Ruci ne te majte te shtratit po I vinte nje komprese ne balle shokut Ramiz,Fatos Nano kish hequr syzet dhe po fshinte lotet,Nexhmije Hoxha rrinte te kembet e shtratit shume e pikelluar...me tutje s'kishte si te mos binte ne sy Edi Rama me i gjati aty,Paskal Milo,Illir Meta,Aleksander Meksi,Prec Zogaj...Ne qoshe te dhomes Namik Dokle po perpiqej te qetesonte Pandeli Majkon qe me sa shihej ishte zalisur...

"Ku eshte Skender Gjinushi?!"-pyeti Sali Berisha...

"Ne banjo!" i thane,"ska dy minuta qe shkoj!"...

"Interesant me kete njeri!"-tha Berisha,"sa here vij te Ramiz Alia ne banjo do e gjej!"

"Lere me,Sali!"I thane te gjithë njezeri,"sa shume ja ke permende edhe ti o burre!"

Pas kesaj u pane nder sy te gjithë me nga nje shikim kuptimplote edhe asnje nuk foli.Ne korridor u degjua zhurme hapash te nxituar...

"Po ju mar pse s'me kini thane!"-u tha sa hyri ne dere Jozefina Topalli,"gjithnji me mbani te mshefta mu!Edhe une jam pjese e ketij grupimi!I pelqen apo nuk I pelqen disave"...me siguri nje aludim I qarte per Nexhmije Hoxhen e cila kishte kthyer shpinen...

"A ka shprese me e cu jashte shtetit?!"-pyeti Berisha ...

"Ka qene France dhe ska me

a do mund te luanim pjesen si duhet!E sheh sa bukur e kemi sjelle gjithshka deri sot 7 tetor 2011?!"...

"Avash,avash Fatoos!"-kerceu Sali Berisha,"ne kete mision nuk ke qene vetem ti!Une kam meriten e madhe sepse mue me ra misioni ma i veshtire...me rrejte e me terhjeke mbrapa pjesen e pakenaqun,pjesen e te perndjekurve,rinine,studentet,ata te cilet ishin kerccenim i vertete per pushtetin tone!Ti e kishe kollaj Fatos se mbas teje kishe krejt komunistet!"...

"Permbahu Sali!"-peshperiti

moton e fushates se ardhshme ashtu do e ve "Rilindje"...

"Kam vetem hallin se mos na del duarsh!"-peshperiti Ramizi,"nuk e kam hallin se na del duarsh nga ana ideologjike se e di qe eshte yni, por I trembem stabilitetit mendor te tij!"...Se jane ca gazetare mistrece qe gati jane te publikojne gjithshka!Harruat Mero Bazen kur pati nxjerre fotot nudo te gazeta "Tema"!?"...

"I pademshem eshte Merua!Mos u beni merak!"-foli Gramoz Ruci...pastaj pasi u zg-erdhi pak vazhdoi "po e teproi

duket ngazellimi I madh ishte I paperballueshem per Ramiz Aline sepse aparaturat nisen te sinjalizojne,doktoret dhe infermieret erdhen me vrap...Ate moment shoku Ramiz mbylli syte pergjithmone!Pandeli Majko u alivanos perseri,Illir Meta nis te qante me gulce...te gjithë u prene e nisen kujen!Nexhmije Hoxha cirrte faqet...

"Dale dale!"-mblodhi veten I pari Sali Berisha,"Shoku Ramiz na la por duhet te permbahemi dhe te vazhdojme misionin!Cfare duhet bere tani?!Te therrasim nje klerik,cfare duhet thirre,prift,pop,hoxhe der- vish?...Cfare?!..."

"Therritni nje prift ortodoks!Meqe eshte edhe Censusi,regjistrimi i popull- sise 2011 le te varroset si ortodoks ose minoritar edhe me mire!"-t ha Spiro Ksera prania e cilit as ishte verejtur deri atehere,"ne ja njohim meritat per ne minoritaret!Ja shkoj une tashi e sjell Hire- sine e tij Janullatosin!?"

"A ta therrasim ndonje prift?"-tha Jozefina,"ne mos ardhte e kapim per zhe-lesh!"...

"Jo jo!"-tha Fatos Nano,"ndoshta duhet te therrasim Hoxhe sepse Ramiz eshte emer mysliman!Po edhe per te thirre Hoxhen duhet ta dime se a ka qene i bere synet shoku Ramiz?!?"...

"Po po ka qene i bere synet!"-i shpetoi Nexhmije Hoxhes...

"Ah korba une...me te degjuar e kam!"- u shfajesua kur pa se te gjithë e shikun me habi...

